REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 399 Prot. Tiranë, më 19 .02. 2026

V E N D I M

Nr.40, Datë 19 .02. 2026

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi[1], bazuar në nenin 32, pika 1, gërma "a", të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*"[2], të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr. 129 Regj, datë 29.05.2025, paraqitur nga ankuesi Z.T kundër Universitetit Bujqësor të Tiranës[3], ku pretendohet diskriminim në kuadër të çdo *"çdo shkak tjetër"*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesi ndër të tjera parashtron:
Unë, Prof. Dr. Z.T , jam pedagog i Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe drejtues i programit të studimit "Arkitekturë Peizazhi" pranë Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit. Kam filluar punë në këtë institucion në vitin 1985, menjëherë pas diplomimit. Pas një periudhe 15 vjeçare me detyra të ndryshme ku përfshihen ajo e Zëvendës Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Koordinatorit për Bujqësinë, Ushqimin dhe Rezervat Shtetërore, Zëvendës Shefit të një prej projekteve më të mëdha të USAID për bujqësinë në Shqipëri, krijuesit dhe drejtuesit të Këshillit të Agrobisnesit Shqiptar, jam kthyer në Universitetin Bujqësor të Tiranës në vitin 2010. Në këtë kohë kam filluar punën për një fushë të re për Shqipërinë, që është arkitektura e peizazhit. Sot Universiteti Bujqësor i Tiranës ka një program të plotë studimi, *Bachelor* dhe *Master*, i cili është i vetmi jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Maqedoninë e Veriut, Kosovë, Mal të Zi dhe Bosnje Hercegovinë. Programi është anëtarësuar në Këshillin Europian të Shkollave të Arkitekturës së Peizazhit. Ndërkohë gjatë këtyre viteve kam punuar për të transformuar plotësisht gjithë peizazhin e Kampusit të Universitetit Bujqësor. Si vlerësim për punën time kam marrë certifikatën "*Mirënjohje e Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit"* (2018) dhe "*Nderi i Universitetit Bujqesor të Tiranës"* (2021).

[1] Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.
[2] Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.
[3] Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën UBT.

Unë jam *Fulbright Scholar,* i Universitetit të Wisconsin, SHBA, dhe Visiting Scientist i Universitetit të Milanos, Itali. Duke qenë që, sidomos pas kthimit nga Universiteti i Milanos, në Korrik 2023, jam gjendur në kushte diskriminimi, që nuk mund ti pergjigjen një realiteti akademik bashkëkohor, po Ju drejtohem me ankesë per diskriminim të vazhdueshëm në marrëdhëniet e punës dhe trajtim të pabarabartë nga drejtuesit e Universitetit Bujqësor të Tiranës, në kundërshtim me parimet e barazisë, të mosdiskriminimit dhe të trajtimit të drejtë institucional. Më poshtë, po ju parashtroj raste të diskriminimit të përsëritur:

- Diskriminim funksional dhe përjashtime ndaj programit të studimit "Arkitekturë Peizazhi".

1. Prej disa vitesh, këtij programi nuk i janë krijuar kushtet e duhura për zhvillimin normal të procesit mësimor. Kështu është ndërhyrë në procesin mësimor duke e dërntuar atë, nuk është siguruar infrastruktura minimale mësimore siç janë hapësirat e përshtatshrne për zhvillimin e mësimit, sidomos të formatit studio, nuk është plotësuar stafi akademik dhe nuk janë miratuar kërkesat për përmirësime të kurrikulës.
2. Programi është përjashtuar padrejtësisht nga fondet e ndërkombëtarizimit, pavarësisht se ka një diplomë duale dhe marrëveshje zyrtare me Universitetin e Viterbos.
3. Programi i studimit arkitekturë peizazhi nuk është përfshirë në projektin "UBT-BOKU 2030" që mbështet nga qeveria Shqiptare dhe që zhvillohet në bashkëpunim me Universitetin e Shkencave të Jetës, BOKU, Vienë.
4. Pavarësisht, se në mënyrë të vazhdueshme, janë drejtuar kërkesa për përrnirësimin të kushteve të programit, ato janë injoruar nga organet Universitare si, Dekanati dhe Rektorati. Shkaku kryesor për mosveprimin nga këto organe, lidhet pikërisht me faktin, se jam unë ankuesi dhe formuluesi i kërkesave dhe drejtues i programit të studimit.

- Diskriminimi individual dhe penalizim i pajustifikuar në marrëdhënien e punës.

1. Në vitin akademik 2022-2023, është penguar padrejtësisht udhëheqja e punimeve të diplomës së studentëve të masterit profesional.
2. Për vitin akademik 2023-2024, nuk jam paguar për orët e mbi ngarkesës, ndonëse ju jam përgjigjur pretendimeve për dokumentacionin. Vetëm kohët e fundit drejtuesit e Universitetit kanë pranuar rifillimin e procedurës.
3. Për vitin 2024-2025 me janë hequr padrejtesisht tre ditë pune për pjesëmarrje në një aktivitet ndërkombëtar të miratuar paraprakisht.

Me anë të kësaj sjellje nga ana e autoriteteve drejtuese, janë cenuar: Neni 115 i Ligjit nr. 80/2015, i cili garanton të drejtën për zhvillim profesional dhe përfshirje në aktivitetet akademike të miratuara. Neni 9 i Kodit të Punës, i cili ndalon veprimet arbitrare dhe çdo formë pengese në realizimin e kontratës së punës, Neni 4 i Ligjit nr. 1022 1/2010, parashikon mbrojtje nga çdo formë trajtimi të pabarabartë që ka si qëllim apo pasojë pengimin ose cënimin e ushtrimit të të drejtave të punës.

- Përjashtim nga jeta institucionale dhe margjinalizim personal.

1. Jam përjashtuar nga aktivitete të brendshme institucionale dhe akademike në mënyrë të pajustifikuar.
2. Ka munguar komunikimi zyrtar me mua ose ai ka qenë informal dhe shpesh i paqartë. Kësisoj, veprimtaria e organeve drejtuese bie ndesh me nenin 20 të ligjit nr. 1022 1/2010, i cili garanton pjesmarrjen e barabartë në jetën publike dhe institucionale, neni 23 i Kushtetutës së Republikës së Shqiperisë, i cili garanton të drejtën për informacion. Ndërkohë që përjashtimi sistematik pa bazë ligjore përbën diskriminim indirekt, i ndaluar si nga jurisprudenca e GJEDNJ-së ashtu edhe nga standardet e Komisionerit (shih vendimin për rastin S. K. vs. Institucionit të Arsirnit Publik, 2022).

- Procedura e ndëshkimit është në kundërshtim me kuadrin legal të Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe me kuadrin ligjor të Republikës së Shqipërisë.

1. Ankesa e paraqitur nga Dekani i Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit në zyrën e Rektorit më datë 27 Nëntor 2024, sipas Kodit të Etikës të UBT duhet të përcillet për Këshillin e Etikës brenda 5 ditëve. Kjo gjë nuk është bërë asnjëherë zyrtarisht, pra me një shkresë të rregullt formale. (Neni 13 i Kodit të Etikës, i Universitetit Bujqësor të Tiranës).

2. Me 23 Janar 2025, dy muaj e gjysëm pas ngjarjes dhe gati dy muaj pas paraqitjes së ankesës në Rektorat unë jam thirrur nga Këshilli i Etikës. Lutem kini në vërnendje se, me 20 Janar 2025 kisha paraqitur një kritikë të argumentuar për procesin e krijimit të Komisionit të Studimeve dhe të Kurrikulës. Argumentat e paraqitur prej meje ishin:

a) Njoftimi për shprehje interesi është dërguar nga zyra AUT-BOKU në orën 19:47, të datës 2 Dhjetor 2024 dhe afati i fundit i paraqitjes së interesit ishte data 5 Dhjetor 2024, ora 14:00. Gjithkush mund ta kuptojë që një afat i tillë nuk u ngjan standardeve europiane (të cilat në këto raste parashikojnë zakonisht një afat kohor - 2 mujor, por asnjëherë më pak se dy javor) dhe e bën të pamundur përfshirjen efektive të 350 profesorëve dhe lektorëve dhe 6000 studentëve të UBT.

b) Dokumenti i thirrjes për "shprehje interesi" dhe i termave të referencës ka një sërë gabimesh në referencat ligjore:
• Neni 6 i ligjit Nr. 80/20 15 nuk ka të bëjë me dhënien e drejtës së institucioneve të arsirnit të lartë për të krijuar struktura shtesë por jep përkufizime të ndryshme në kuadër të vetë ligjit.
• Neni 7 i ligjit Nr. 80/20 15 titullohet "Ministria përgjegjëse për arsirnin" dhe nuk ka lidhje me standardet.
• Neni 17 i ligjit Nr. 80/2015 titullohet "Organizimi i institucioneve të arsimit të lartë" dhe nuk ka lidhje me "rëndësinë e qeverisjes gjithëpërfshirëse në arsimin e lartë".
• Neni 35 i ligjit Nr. 80/2015 titullohet "Hapja, mbyllja dhe riorganizimi i programeve të studimit në institucionet e arsimit të lartë" dhe nuk ka lidhje me "Kërkesën per miratimin e brendshëm të programeve të reja të studimit përpara dorëzimit në Ministrinë përgjegjëse për Arsimin e Lartë.
• Neni 71 i ligjit Nr. 80/2015 titullohet "Programet e studimit në institucionet e arsimit te lartë" por nuk flet për "Autorizim të universiteteve që të krijojnë struktura për vlerësimin dhe përmirësimin e kurrikulës.

c) Pavarësisht referencave të gabuara ligjore, një nga problemet kryesore që konstatohet nga Dokumenti i thirrjes për "shprehje interesi" dhe i termave të referencës është që fryma e tyre është në kundërshtim me ligjin Nr. 80/2015 i cili në nenin 25 të tij përcakton: "Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron". Në fakt në këto dokumente dhe të tjera që lidhen me projektin AUT-BOKU Departamenti anashkalohet dhe thuajse nuk përmendet fare.
d) Konstatimi se "Të dhënat nga AUT konfirmojnë se asnjë departament nuk mbulon aktualisht me shumë se 50% të moduleve të ofruara nga programet e tij Bachelor", dëshmon për një perceptim të gabuar të ngarkesës mësimore në universitete e cila nuk matet me numër modulesh. Kështu konstatimi i mësipërm rezulton i gabuar të paktën për programin e studimit "Arkitekturë peizazhi".
e) Dokumenti për termat e referencës përcakton 3 kritere teknike të vlerësimit të kandidateve nga stafi akademik, por nuk thotë asgjë se si do të vlerësohen kandidatët studentë.
j) Së fundi, ashtu siç del edhe nga njoftimi zyrtar, megjithëse në dokumentin "Termat e Referencës për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Studimeve dhe Kurrikulave në Universitetin Bujqësor të Tiranës" flitet për emërim të anëtarëve të komisionit, në fakt Senati Akademik me datë 6 Dhjetor 2024 nuk ka bërë asnjë vlerësim teknik të kandidave, por ka bërë zgjedhje me votim. Dallimi midis konkurimit sipas aftësive teknike dhe zgjedhjeve është një nga aspektet e rëndësishme që dallon shoqëritë totalitare dhe etatiste nga shoqëritë demokratike.

Më datë 31 Janar 2025, jam paraqitur në Këshillin e Etikes dhe pasi kam shpjeguar gjithë ecurinë e ngjarjes kam kërkuar pavlefshmeri të procesit pasi ankesa nuk ishte paraqitur në Këshillin e Etikës sipas procedurës që përcakton Kodi i Etikës dhe as nuk kishte një shkresë zyrtare nga Rektori për të nisur këtë procedurë nga Këshilli i Etikës. (Neni 13 i Kodit të Etikës i Universitetit Bujqësor)
4. Kam kërkuar që Kryetarja e Këshillit të Etikës të përjashtohet nga ky gjykim për konflikt interesi pasi ajo ka qenë Zv. Dekane e ngarkuar me mësimin, në kohën kur ka filluar konflikti mbi pagesën e orëve të mbingarkesës (të parashtruar në argumentin II) dhe njëkohësisht është në të njëjtin departament me ish Drejtuesin dhe Drejtuesin e Njësisë Kryesore.
5. Pasi i kam paraqitur pretendimet e mia me shkrim dhe kam njoftuar edhe Senatin Akademik, Këshilli ka pretenduar që ka një shkresë nga Rektori të datës 8 Janar 2025 (rreth 1 muaj e gjysëm pas paraqitjes së ankesës). Kjo shkrese në fakt vjen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe mbi të është një shënim me dorë i Rektorit. Pra edhe kjo e ashtuquajtur shkresë është jashtë afateve proceduriale.

6. Në mbledhjen e datës 31 Janar 2025, të Këshillit të Etikës, diskutimi është i regjistruar dhe Kryetarja e Këshillit të Etikës ka pranuar që dokumentacioni në Këshill ka ardhur pa shkresë të Rektorit. Ajo pretendon që vonesa e gjykimit ka ardhur pasi Këshillit të mëparshëm i kishte mbaruar mandati dhe akoma nuk ishte krijuar Këshilli i ri. Këtë pretendim e kam hedhur poshtë pasi asnjëherë nuk mund të ketë boshllëk institucional. Sidoqoftë sipas vetë Kryetares thuhet që Këshilli i ri është zgjedhur në pjesën e parë të Dhjetorit 2024.
7. Në pamundësi për të argumentuar dhe mbrojtur shkeljet proceduriale, me datë 6 Shkurt 2025, Këshilli ka marrë një vendim të ndërmjetëm për të shtyrë hetimet mbi këtë çeshtje dhe ka kërkuar të mbledhë dëshmitarë dhe dokumente për një periudhë të gjatë kohe. Shumica e këtyre dokumenteve

jane *email*-e, ku unë kam ngritur probleme lidhur me keqmenaxhimin e Universitetit Bujqësor dhe me diskriminimin e programit të Studimit që unë drejtoj. Në shumë raste ato nuk kanë lidhje fare me çështjen e ankesës së Dekanit të Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit.

8. Më datë 7 Mars 2025 Këshilli ka marrë vendim me shumicë votash për të më larguar nga puna. Unë jam njohur me këtë vendim një muaj e gjysëm me vonë nga marrja e tij dhe 10 ditë pasi më njoftuan për vendimin e Rektorit nr. 10, datë 9 Prill 2025 sipas të cilit unë kam marrë masë disiplinore paralajmërim për pushim nga puna". Kësisoj ankesa ndaj meje është shqyrtuar me vonesë pa akt formal nisës nga Rektori, dhe me përbërje të papërshtatshme të Këshillit të Etikës. (Kam kërkuar përjashtimin e Kryetares për konflikt interesi, por pa sukses). Duke theksuar qëndrimin për një proces të parregullt gjykimi nga Këshilli i Etikës i Universitetit Bujqesor. Gjithashtu shtoj që si ankesa e Dekanit z. Sh. ashtu edhe dëshmitë e mbledhura janë shpesh të pasakta dhe kontradiktore dhe këshilli nuk ka realizuar asnjë ballafaqim timin me ankuesin ose dëshmitarët.

Vendirni për largimin nga puna më është komunikuar me vonesë dhe jashtë çdo afati procedurial. Për sa më sipër, organi publik ka cenuar nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë që garanton të drejtën për proces të rregullt ligjor. Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri:

1. Konstatimin e paligjshmërisë të veprimeve të ndërmarra ndaj meje.
2. Konstatirnin e diskrirninimit në punë ndaj ankuesit.
3. Të kërkohet apo rekornandohet shfuqizimi i vendimit nr. 10 datë 9 Prill 2025, të Rektorit të UBT, si të paligjshëm dhe të mbështetur mbi një proces disiplinor proceduralisht të pavlefshëm.
4. Të ndërmerren masa administrative apo rekomanduese ndaj personave përgjegjës për veprimet diskuiminuese dhe shkeljet ligjore.
5. Të urdhërohet rivendosja e statusit tim profesional dhe akademik si dhe të sigurohet trajtim i barabartë për programin që unë drejtoj.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma "a", të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Në nenin 1 të LMD përcaktohet se: ***"****Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër".*

Bazuar në nenin 7, të LMD, *mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë,* që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e punësimit, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të kapitullit II, të LMD. Në nenin 12, pika 1, germa "c" të LMD, parashikohet: *"1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ..... c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës;"*

Bazuar në nenin 5, pika 1, të LMD, ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, me *e-mail*-in e datës 04. 06.2025 ankuesit iu kërkua plotësimi dhe saktësimi i ankesës, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit në kuadër të "*çdo shkak tjetër*". Nëpërmjet *e-mail*-eve të datës 5 dhe 10 qershor 2025, ankuesi plotësoi ankesën duke parashtruar ndër të tjera:

"Gjykimi im, bazuar ne fakte dhe dokumente është se diskriminimi ndaj programit të studimit"Arkitekturë Peizazhi" ka si shkak xhelozinë e programeve tradicionale, një pjesë e të cilave, megjithë mbështetjen e veçantë që marrin nuk kanë qenë të suksesshem vitet e fundit. Drejtuesit kryesorë të Universitetit Bujqësor të Tiranës, vijnë nga i njënjti departament.

Diskriminimi ndaj meje personalisht vjen për shkak të qëndrimeve të mia kritike, për mënyrën se si menaxhohet Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe në mënyrë të veçantë për menyrën e trajtimit të programit të studimit arkitekturë peizazhi, të cilin unë e drejtoj.....

1. E-mail drejtuar rektorit te UBT, datë 28 Prill 2023, ku unë shprehem kritik për mënyren se si promovohet Universiteti Bujqësor si dhe nënvizohet shqetësimi për pengesat e krijuara nga Dekani i Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedist për procesin e diplomimit të studenteve të arkitekturës së peizazhit. Lidhur me këtë e-mail nuk kam marrë përgjigje të shkruar, por më datë 2 maj 2023, Dekani dhe Rektori kanë thirrur një mbledhje të stafit akademik dhe ndihmës akademik të fakultetit tone ku midis të tjerave kanë deklaruar që arkitektura e peizazhit nuk është e rëndësishme për universitetin tonë. Rektori disa herë publikisht e ka mohuar organizimin e kësaj mbledhje.
2. E-mail drejtuar drejtuesve të strukturave të Universitetit Bujqësor të Tiranës ku renditen problematikat e krijuara nga drejtuesit lidhur me programin e studimit arkitekturë peizazhi. Të nesërmen në një mbledhje të drejtuesve të strukturave të UBT, rektori, lidhur me këtë çeshtje ka

këmbëngulur të më mohojë të drejtën e fjalës dhe më ka akuzuar se po gënjeja. Faktet e trajtuara prej meje mund të vërtetohen. Në këtë mbledhje kam kërkuar informacion mbi financimet në kuadër të ndërkombëtarizimit të universiteteve dhe rektori ka refuzuar të përgjigjet,
Në vazhdim të kësaj ngjarje rektori dhe dekani më datë 28 Shtator 2023 kanë ardhur në departament dhe kanë hedhur një sërë akuzash të pavërteta ndaj meje.
3. Një sërë komunikimesh me e-mail me Senatin Akademik në periudhën maj-qershor 2024, ku kam kërkuar informacion mbi financimet në kuadër të ndërkombëtarizimit të universiteteve. Informacionin munda ta marr vetëm pas një takimi me ministren e arsimit. Pas kësaj ngjarje administrata e UBT nuk më ka paguar orët e mbingarkesës për vitin akademik 2023-2024. Kjo u bë e mundur vetëm pak kohë më parë. Pra, afro një vit me vonesë.
4. E-mail i datës 20 Janar 2025 ku kritikoj procedurat e ndjekuar për ngritjen e Komisionit të Studimeve dhe Kurikulës (SCC) në kuadër të të projektit UBT-BOKU 2030 si dhe mënyrën e menaxhimit të këtij projekti. Tre ditë më vonë thirrem në Komisionin e Etikës. Procedurat e ndjekura nga Komisioni i Etikës nuk janë të rregullta.
5. Shkresë drejtuar Senatit Akademik më datë 6 shkurt 2025 dhe për dijeni përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve dhe të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ku kërkoj anullimin e vendimit të mësipërm. Të nesërmen njoftohem se Keshilli i Etikës kishte marrë një vendim të ndërmjetëm për shtyrjen e hetimeve dhe e përdori kohën për të gjurmuar gjithë komunikimet e mia elektronike për të gjetur shkelje etike dhe solli një numër personash për të dëshmuar kundër meje. Të gjitha pretendimet e komisionit i kam hedhur poshtë jo vetëm proceduralisht por edhe faktikisht."

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 839/1 prot., datë 01.07.2025, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga UBT, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa.

2. Me shkresën nr.2336/9 prot., datë 15.07.2025, UBT ka kthyer përgjigje, duke parashtruar ndër të tjera:

Për sa i përket procedurës në kuadër të procedimit disiplinor në ngarkim të ankuesit për dhënien e masës disiplinore "*vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra*", sqarojmë se kjo procedurë është ndjekur në zbatim të ligjit nr 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë*", Statutit të UBT, të miratuar me urdhrin nr.586, datë 02.12.2024 të MASR, Rregullores së Këshillti të Etikës, të miratuar nga Senati Akademik me nr.1644/2 prot datë 27.06.2023, si dhe Kodit të Procedurave Administrative.

Referuar pretendimeve të ankuesit për përjashtimin nga aktivitetet e brendshme institucionale që kanë të bëjnë me projektin UBT-BOKU, ju informojmë se bazuar në përgjigjen e ardhur nga sektori i IT së UBT, z.T. është i përfshirë në të gjitha njoftimet elektronike që lidhen me projektin në fjalë.

Lidhur me pretendimet e ankuesit për përjashtim nga aktivitetet e brendshme akademikë që kanë të bëjnë me projektin UBT-BOKU, ju bëjmë me dije se personeli akademik z.T. nuk ka shprehur

interesin pranë Dekanatit të Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit lidhur me grupin e punës për programet e studimit pranë këtij fakulteti.

Për pretendimet e ankuesit në lidhje me pagesën e orëve shtesë për vitin akademik 2023-2024, sqarojmë se vonesa në pagesë i detyrohet korrigjimeve nga ana e ankuesit si dhe pasaktësive të plotësimit të deklarimit të ngarkesës të realizuar në auditor nga ana e tij.

Sa i përket praktikës së ndjekur në lidhje me heqjen e ditëve të punës së pretenduar nga ankuesi për pjesmarrjen në aktivitetin e mbajtur në datat 11 dhe 12 mars 2025 në Budapest, ju informojmë se bashkëlidhur do të gjeni kopjen e praktikës së ndjekur për problematikat e ngritura nga ankuesi.

3. Ankuesi ka depozituar prapësimet në lidhje me qëndrimin e mbajtur nga UBT, të cilat janë administruar pranë Komisionerit me nr. 939/3 prot datë 11.08.2025. Ndër të tjera ankuesi parashtron:

Çështja bazë në ankesën time është vendimi nr.10, datë 07.03.2025, i Këshillit të Etikës së Universitetit Bujqësor të Tiranës. Ky vendim përbën një rast të paprecedent që një Këshill Etike Universiteti, propozon masën ekstreme "Largim nga detyra" për një Profesor Doktor, me karrierë mbi 40 vjeçare, i cili jo vetëm nuk ka asnjë lloj vërejtje të dhënë nga ky organ por nga çdo strukturë tjetër, gjatë gjithë karrierës së tij, por përkundrazi, është vlerësuar zyrtarisht për kontributin e tij të jashtëzakonshëm si "Nderi i Universitetit Bujqësor të Tiranës".

I. Për sa i përket procedimit disiplinor për dhënien e masës disiplinore "vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra", nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur mund të verifikohen një sërë shkeljesh: (i) shkelje e afateve procedurale; (ii) mungesë e shkresës zyrtare për fillimin e çështjes nga Këshilli i Etikës; (iii) konflikt interesi i Kryetares së Këshillit të Etikës; (iv) mungesë vendimit të ndërmjetëm nga organi publik kompetent për marrjen e vendimit përfundimtar; (v) probleme me dëshmitarët dhe dëshmitë; (vi) mungesë e vendimit të Senatit Akademik të Universitetit Bujqësor të Tiranës; (vii) mungesë e njoftimit për vendimin përfundimtar të Këshillit të Etikës nr.10, datë 07.03.2025. Ndofta do të mjaftonte edhe vetëm njëra nga këto parregullsi për ta konsideruar të gjithë procedimin disiplinor dhe vendimin e këshillit të Etikës nr.10, datë 07.03.2025, e për pasojë edhe vendimin e Rektorit nr.23, datë 09.04.2025, të pavlefshëm.

i. *Shkelje e afateve procedurale:* Ngjarja e pretenduar ka ndodhur më 8 nëntor 2024, ndërsa ankesa është bërë nga Dekani në 27 nëntor 2024. Këtë ankesë Rektori, sipas Kodit të Etikës, duhej ta kalonte zyrtarisht për shqyrtim në Këshillin e Etikës brenda 5 ditësh (Kodi i Etikës, neni 13, pika 4). Unë jam njoftuar për ankesën dhe nisjen e procedurës nga Këshilli i Etikës, më 23 janar 2025, pas më shumë se 55 ditësh nga paraqitja e ankesës.

Në takimin e zhvilluar më datë 31 janar 2025, duke reaguar ndaj kërkesës time për pavlefshmëri të procesit, Kryetarja e Këshillit të Etikës, lidhur me ketë rast ka thënë tekstualisht (procesverbali audio i mbledhjes së Këshillit të Etikës, 31 janar 2025, shkresa 3500/19 prot., datë 07.02.2025 dhe dvd) : "*Në fakt nuk ka pasur një Këshill Etike Efektiv. Këshilli i Etikës është ngritur vetëm në datë 10 dhjetor, është bërë efektiv; ka vendim senati ku kanë kaluar të gjithë anëtarët aktualë. Pas datës 10 është marrë kërkesa në dorë. Duke patur parasysh që deri në datë 22 kemi qenë në punë dhe pastaj kemi qenë me pushime, prandaj kjo mund të ezaurojë pjesën e vonesës së shqyrtimit të ankesës.".*

Duke ju përgjigjur argumentit tim që nuk mund të ketë boshllëk institucional, kryetarja ka vazhduar: "*Katër vjet e ka mandatin komisioni*."

Në të drejtën administrative, parimi i vazhdimësisë institucionale është një nga shtyllat që garanton funksionimin e pandërprerë të institucioneve publike, pavarësisht ndryshimeve në përbërje, mandate apo struktura të organeve. Ky parim ndonëse nuk është i formuluar në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kodin e Procedurave Administrative, rrjedh nga një kombinim i dispozitave ligjore, praktikave institucionale dhe administrative. Administrata publike është e detyruar të respektojë parimin e sigurisë juridike dhe të mbrojë interesat legjitime të personave. Ky parim nënkupton se institucionet publike duhet të veprojnë në mënyrë të qëndrueshme, të parashikueshme dhe të mos i vendosin subjektet në pasiguri ligjore për shkak të boshllëqeve apo vonesave administrative. Një element thelbësor i kërij parimi është se një organ kolegjial, si Këshilli i Etikës, vazhdon të ushtrojë funksionet e tij deri në momentin e konstituimit të këshillit të ri, edhe nëse mandati formal ka përfunduar.

ii. *Mungesë e shkresës zyrtare të rektorit për fillimin e procedurës nga Këshilli i Etikës*. Në dokumentet e marra zyrtarisht prej meje nga Këshilli i Etikës, nuk kishte asnjë shkresë përcjellëse për ankesën në Këshillin e Etikës (shkresa nr.3500/7 prot., datë 28.01.2025). Pas paraqitjes së kërkesës time me shkrim, me të cilën u njoftua edhe Senati Akademik, për pavlefshmëri të procesit, në Komision është shfaqur një memo, e Drejtoreshës së Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Juridike për Rektorin, e datës 8 janar 2025 (shkresa nr.3500/1 prot., datë 8.01.2025) Mbi këtë shkresë, të kësaj drejtorie, ka një shënim me dorë të Rektorit "*Të përcillet pranë Këshillit të Etikës për t'u trajtuar*". Data e shënimit e njetë 8.1.2025. Konstatimi im në mbledhjen e datës 31 janar 2025 se nuk ka një shkresë zyrtare nga rektori për Këshillin e Etikës, dhe ju më keni sjellë mua ankesën e zotit Sh. dërguar në Rektorat, Kryetarja i është përgjigjur : "*Sepse këtë më kanë sjellë edhe mua*" (procesverbali audio i mbledhjes së Këshillit të Etikës i datës 31 janar 2025, shkresa përcjellëse nr.3500/19 prot., datë 07.02.2025 dhe dvd)

Shkresat zyrtare duhet të zbatojnë udhëzimet e vendimit nr.4, datë 19.06.2017 "*Për miratimin e "Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë*". Në mungesë të një akti të vlefshëm të përcjelljes nga Rektori, veprimi i Këshillit të Etikës bie në kundërshtim me procedurën standarde dhe nuk është konform Kodit të Etikës, duke e bërë procesin të pavlefshëm.

iii. *Konflikti i interesit i kryetares së Këshillit të Etikës*. Kryetarja e Këshillit të Etikës ka qenë më parë në pozitën e zëvendës dekanes për mësimin dhe është ajo që e ka penguar pagesën e mbingarkesës që përbën shkakun e konfliktit me dekanin aktual, me të cilin janë në të njëjtin departament prej shumë vitesh. Angazhimi i Kryetares së Këshillit të Etikës në këtë proces vërtetohet nga një numër dokumenteshh që janë në materialet e sjella nga UBT. Unë personalisht ia kam vënë në dukje këtë fakt Kryetares së Këshillit të Etikës si në takimin e datës 31 janar 2025, ashtu edhe në ballafaqimin e datës 20.02.2025. Ajo ka insistuar që do të vazhdonte drejtimin e procesit. Kjo përbën shkeje të nenit 30, të ligjit nr.44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*" dhe ligjit Nr.9367, datë 07.04.2005 "*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*", nenet 3, 4, 6 dhe si pasojë zbatimi i nenit 40 të

ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, e bën të pavlefshëm procesin e shqyrtimit nga Këshilli i Etikës si dhe vendimin nr.10, datë 7 mars 2025.

iv. Vendimi i ndërmjetëm duhej marrë nga Rektori, Administratori ose Senati Akademik. Sipas nenit 67, pika 1, të ligjit nr.44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*", organi publik i cili është përgjegjës për marrjen e vendimit përfundimtar, mund të marrë edhe vendime të ndërmjetme. Në këtë rast, Këshilli i Etikës duhej t'i drejtohej Senatit Akademik, Rektorit ose Administratorit me kërkesë për shtyrje afati dhe jo të merrte vetë vendimin.

v. *Problematika me dëshmitarët dhe dëshmitë.* Në procesverbalet e dëshmive mund të verifikohet që Këshilli i Etikës nuk ka sqaruar asnjë prej dëshmitarëve për rëndësinë e dëshmisë dhe përgjegjësinë që mban dëshmitari për dëshmi të rreme. Akuzuesi vetë e ka shtrembëruar ngjarjen për të cilën ai ankohet. Në dëshminë e tij para Këshillit të Etikës ka elementë të dëshmisë së rremë. Vetë dëshmitarët e sjellë nga akuzuesi kanë ndryshime thelbësore në dëshmitë e tyre. Në këto kushte, Këshilli duhej të ishte ndalur në verifikimin e dëshmive dhe të bënte përpjekje për të gjetur të vërtetën.

Pas shtyrjes së afatit, për të krijuar idenë e një veprimi të përsëritur, në këshill janë thirrur një sërë dëshmitarësh të cilët nuk kanë lidhje me ngjarjen të cilës i referohet ankuesi. Një pjesë e këtyre dëshmive të administruara në Këshill janë opinione personale, jo fakte të verifikueshme. Një nga "provat më të rëndësishme", është që janë shkruar shumë e-*mail*-ee (në dy vjet 96 ose 97 *e-mail*-e) dhe se ato në disa raste i kanë marrë gati 100 vetë, po kështu theksohet se nëj një email unë, duke ju uruar kolegëve fundjavë të mbarë, kam rekomanduar leximin e romanit "Ferma e Kafshëve". Një rekomandim për të lexuar një libër të famshëm duke shprehur thjesht një opinion personal, artistik apo akademik, qoftë ky kritik apo metaforik, konsiderohet ofendim. Ndërkohë, në këshill nuk është paraqitur ndonjë individ i cili të jetë ankuar për veten e tij lidhur me këtë fakt.

Unë jam njohur me dëshmitë e Dekanit, z. Sh. , ish Dekanit, z. Kristo dhe Drejtoreshës së Burimeve Njerëzore, zj.Shore shumë kohë pas mbylljes së procesit dhe nuk më është ofruar mundësia të reagoj ndaj tyre (shkresa 3500/42 prot., datë 28.04.2025). Sidomos këto dëshmi kanë të pavërteta të verifikueshme si dhe sharje dhe ofendime ndaj të cilave edhe vetë Këshilli duhej të kishte reaguar. Dëshmitë e tyre më shumë se të sjellin fakte lidhur me ngjarjen synojnë të krijojnë, të imponojnë ndaj anëtarëve me moshë relativisht të re të Këshillit të Etikës profilin e një njeriu problematik, të ashpër etj. Mendoj që një prirje e tillë është antiligjore.

Analiza e procesverbaleve të mbajtur në takimet me dëshmitarët evidenton që vendimi disiplinor ishte i paracaktuar, i parregullt dhe i paragjykuar. Kjo duket në faktin që Kryetarja e Këshillit të Etikës në disa raste e fillon takimin me dëshmitarët duke iu sqaruar që "dëshmitarët e tjerë kanë konfirmuar shkeljen në vazhdimësi të etikës nga prof.T. ". Ndërkohë, për të hedhur poshtë përpjekjen antiligjore të krijimit artificialisht të një profili timin problematik, i ashpër dhe pa etiketë, veç faktit që ky është një veprim antiligjor, do të mjaftonte të sqarohesh që gjatë gjithë karrierës time mbi 40 vjeçare, në punë të niveleve dhe rëndësive të ndryshme, unë nuk kam asnjë lloj vërejtje, por përkundrazi në UBT kam marrë dy certifikata vlerësimi, të akorduara në kohë të

ndryshme: “Çertifikatë Mirënjohje “ nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit, në datë 17 dhjetor 2017 dhe certifikatën “nderi i Universitetit” më 20 tetor 2021. Një nga dëshmitarët e rëndësishëm, ish Dekani i Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit, Prof.I.K , i cili në dëshminë e tij para Komisionit të Etikës pretendon që unë “kështu kam qenë që kur isha i ri, një person problematik” është një nga propozuesit që unë të jem “Nderi i Universitetit”. Është e kuptueshme që unë “person problematik” jam bërë për shkak të kritikave të argumentuara për keqmenaxhimin e Universitetit dhe në mënyrë të veçantë, të fakultetit që ai ka drejtuar për 4 vjet.

vi. *Mungesë e vendimit të Senatit Akademik të Universitetit Bujqësor të Tiranës*. Në shkresën nr.3500/33 prot., datë 17.03.2025 dhe në shkresën e Rektorit nr.2500/34 prot., datë 30.03.2025, sqarohet se Statuti i UBT kërkon që vendimi i Këshillit të Etikës të kalojë në Senatin Akademik. Në fakt siç vërtetohet nga dokumentacioni i paraqitur vendimi nuk ka kaluar në Senatin Akademik.

vii. Mungesë e njoftimit në kohë për vendimin e këshillit të Etikës. Vendimi për masën disiplinore “largim nga detyra” është marrë në 7 mars 2025 nga Këshilli i Etikës, por unë jam njoftuar vetëm më 9 prill 2025, jo nga organi vendimarrës, por nga Rektori. Këshilli më dërgoi zbardhjen e vendimit vetëm pas kërkesës time me shkrim, më 28.04.2025.

Dokumentet e sjella nga vetë Universiteti Bujqësor lidhur me procedimin disiplinor për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra” si dhe procesverbali audio i mbledhjes së datës 31.01.2025, dëshmojnë shkelje të të drejtës kushtetuese për një proces të drejtë gjykimi si dhe provojnë që vendimi nr.10, datë 7 mars 2025 është i padrejtë dhe i pavlefshëm.

II.*Lidhur me ankesën për përjashtim në mënyrë të pajustifikuar nga aktivitetet e brendshme institucionale dhe akademike.*

Për të hedhur poshtë këtë ankesë, UBT ka sjellë dokumente që tregojnë se unë jam i përfshirë në listat e disa njoftimeve, por nuk tregohet që të jem njoftuar për takimet e datës 29.01.2025 dhe 20.03.2025. Gjithashtu, nuk shpjegohet se pse unë nuk kam marrë sqarime për *e-mail*-et e mia të datës 20 mars dhe 22 prill 2025, në të cilat ka qenë pjesë edhe vetë Rektori i Universitetit Bujqësor të Tiranës.

Për të plotësuar këtë ankesë dhe për të treguar që përjashtimi ka qenë një dukuri e përsëritur, krahas dokumenteve të mëparshme, po sjell bashkëlidhur edhe dokumentin e mungesës së njoftimit për aktivitetin e organizuar nga Projekti UBT-BOKU, më 29 janar 2025 dhe nga Rektori i UBT në datën 1 korrik 2025.

Unë nuk jam ankuar që nuk kam marrë njoftime mbi publikimet apo thirrjet për aplikime nga Projekti UBT-BOKU. Vërejtjet e mia në këtë fushë kanë qenë të lidhura me standardet e pjesëmarrjes dhe të komunikimit.

III.Lidhur me ankesën time për mospagimin e orëve shtesë për vitin akademik 2023-2024.

UBT pretendon se vonesa e pagesës (pagesa është realizuar pas paraqitjes së ankesës time në zyrën tuaj) është shkaktuar për shkak të vonesës time për të bërë korrigjimet e duhura. Për të mbështetur pretendimet e tij UBT duhet të sqarojë sa vijon:

- Pse mungon përgjigja për shkresën time të datës 26 qershor 2024?
- Pse Zv.Dekania e mësimit, aktualisht kryetare e Këshillit të Etikës, nuk ka dhënë përgjigje për emailet e mia të datave 3 dhe 5 korrik 2024?
- Pse nuk ka përgjigje për shkresën e Përgjegjësit të Departamentit, datë 08 korrik 2024?
- Pse Dekani aktual dhe akuzuesi im në Këshillin e Etikës, nuk iu përgjigj asnjë *e-mail* gjatë muajit shtator, nuk pranoi të më presë në zyrë dhe nuk pranoi të më fliste në mjediset e kampusit universitar?
- Pas shkresës së përgjegjësit të ri të departamenti për riparaqitjen e dokumenteve të pagesës së muajit shtator iu përgjigj me pretendime të reja pas rreth një muaj e gjysëm dhe pse nuk ktheu asnjëherë përgjigje për shkresën e Përgjegjësit të Departamentit datë 8.11.2024?

Ndërkohë, Këshillit të Etikës në mbledhjen e datës 31 janar 2025 i kam kërkuar të më rekomandojë se "ku mund të takohesha dhe të sqarohesha unë me z.Sh. nëse ai për dy muaj rresht nuk i përgjigjej *e-mail*-eve, nuk i përgjigjej shkresave dhe nuk më priste në zyrë?" E vërteta është që procesi u rihap vetëm në mars 2025, pas paraqitjes së ankesës time në Këshillin e Etikës në muajin shkurt 2025.

IV.*Penalizim për pjesëmarrje në një aktivitet ndërkombëtar.*

Mua më janë hequr 3 ditë punë për pjesëmarrje në takimin e Komitetit të Menaxhimit të Projektit CA23128 *"Connecting Landscape Architecture Archives to enchance European landscape practice and education"* (ConnectLAA). Takimi u zhvillua nga data 11 deri 12 mars 2025 pranë arkivave të qytetit të Budapestit, Hungari. Argumentimi ishte se unë nuk kisha leje nga Rektori.

Sipas VKM nr.329/2017 (pika 12), për udhëtime deri në 2 javë leja jepet nga Dekani dhe është ai që njofton Rektorin, jo pedagogu.

Unë kam dorëzuar kërkesën për leje në datë 25 shkurt 2025 në Departament. Ashtu siç konfirmohet në dokumentin e Përgjegjësit të Departamentit nr.7 prot. datë 2.4.2025, konform procedurës që ndjek Universiteti Bujqësor, ai ka konceptuar kërkesën për leje dhe e ka dërguar për firmë në Dekanat. Shkresa është firmosur nga Zv.Dekania e autorizuar nga Dekani. Procedura ka mbetur pezull pasi nuk ka qenë e mundur të kontaktohet drejtpërdrejt Zv.Rektorja, kurse sekretariati i Rektoratit nuk ka pranuar të mbajë shkresën. Sot edhe kësaj dite nuk ka asnjë refuzim të arsyetuar për këtë leje.

Përgjegjësi i Departamentit fillimisht, ka firmosur dhe paraqitur listëprezencën e stafit me 3 ditë të miat me leje jashtë shtetit. Pas ndërhyrjes së Dekanatit ai ka kërkuar interpretim nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe e Shërbimeve Juridike, por në fakt, ka ardhur një përgjigje nga Administratorja e Universitetit dhe nga Dekani. Si rezultat, mua më janë hequr tre ditë pune. Pasi jam njohur me përgjigjet e Administratores dhe dekanit të datës 03.04.2025, unë ju jam drejtuar me shkresë zyrtare (datë 7.4.2025) ku sqaroj procedurën që kam ndjekur e cila parashikon që unë të paraqes një kërkesë në Departament dhe më tej, Përgjegjësi i Departamentit koncepton shkresën që miratohet në Dekanat dhe se në bazë të VKM nr.239, viti 2017 leja për periudha deri dy javore jepet nga Dekani. Për pasojë, pas firmosjes së lejes në Dekanat e kam konsideruar lejen të miratuar.

Duke qenë se nuk kam marrë asnjë përgjigje prej tyre, u kam shkruar një *e-mail* bashkë me Rektorin në datë 28 prill 2025 për të evidentuar faktin që akoma nuk kisha marrë përgjigje për shkresën time datë 7 prill 2025, protokolluar në Dekanat me nr.137 prot. dhe në protokollin e UBT me nr.1132/3

prot. Në vazhdim të sqarimeve të dhëna në shkresën e datës 7 prill 2025, kam bërë të qartë se unë jam përzgjedhur si MC Member (Anëtar i Komitetit të Menaxhimit) në kuadër të COST Action: CA23128 nga Koordinatorja Kombëtare për COCT për Shqipërinë, pas një procesi përgjedhje të zhvilluar ndërmjet disa aplikantëve për të njëjtin pozicion. Ky emërim e ka bazën tek një punë e gjatë që kam zhvilluar unë në përgatitjen e këtij projekti, e cila fillon në vitin 2019 me themelimin e rrjetit europian të arkivave të arkitekturës së peizazhit (NELA) dhe me faktin që unë kam qenë një nga bashkëpropozuesit e projektit. Qenia ime si MC Delegate, parashikon realizimin e detyrave të ndryshme përfshirë pjesëmarrjen në takimet e MC, kontribut në hartimin e planeve të punës, përfaqësimi i interesave kërkimore shkencore të institucionit, etj.

Në këtë kuadër kam theksuar se çdo përfaqësim i imi pas emërimit nuk është vetëm angazhim dhe detyrim personal në zhvillimin profesional, por edhe një detyrim institucional për të kontribuuar në promovimin dhe përfaqëimin e denjë të institucionit tonë në arenën ndërkombëtare.

Administratorja pretendon se, meqënëse dokumenti nuk ishte "protokolluar" zyrtarisht, ai nuk është një dokument zyrtar i vlefshëm. Ky argument nuk qëndron pasi vet firma e dekanit është autoriteti. VKM nr.329/2017, specifikon që dekani është autoriteti që jep lejen. Kur dekani firmos dokumentin, kjo do të thotë se ai e miraton atë. Akti i "protokollimit" është një hap pasues administrativ për të regjistruar vendimin, jo aktin e marrjes së vendimit në vetvete. madje, ajo kërkon që të ketë edhe urdhrin e dekanit që i lejon Zv.Dekanes që të firmosë. Ndërsa dekani shkon më tej kur thotë se në dekanat nuk ka një kërkesë zyrtare timen për leje, ndërkohë që sipas procedurës zyrtare të Universitetit unë kërkesën e paraqes në departament dhe është përgjegjësi i departamentit i cili koncepton shkresën që shkon në dekanat. Sot e kësaj dite unë nuk kam asnjë përgjigje as nga administratorja, as nga dekani dhe as nga rektori. Gjykoj se ajo që ka ndodhur ka pamjen e një kurthi burokratik administrativ.

Unë si punonjës nuk jam përgjegjës për procedurat e brendshme administrative të universitetit. Dështimi për të marrë firmat e mbetura dhe për të protokolluar dokumentin është një dështim administrativ i brendshëm i universitetit, jo faji im. Pra, unë nuk mund të penalizohem për mungesën e efikasitetit të tyre ose për një zv.rektore dhe një drejtor që nuk bëjnë punën e tyre. Universiteti nuk mund të mbajë ligjërisht pagën time për një dështim administrativ nga ana e tij.

3. Bazuar në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, ku parashikohet se: *"8. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.*", për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, me shkresën nr. 839/4 prot datë 26.8.2025, Komisioneri ka njoftuar palët për zhvillimin e një seance degjimore më datë 09.09.2025, e cila nuk u zhvillua për shkak të pamundësisë nga ana e përfaqësuesve të autorizuar të UBT për të marrë pjesë.

Për t'i dhënë mundësinë palëve që të marrin pjesë në seancë dëgjimore, Komisioneri vendosi shtyrjen e seancës dëgjimore më datë 14.10.2025. Data e seancës dëgjimore iu komunikua palëve me shkresën nr. 839/6 prot., datë 17.09.2025.

Seanca dëgjimore e datës 14.10.2025 u zhvillua me pjesmarrjen e të dy palëve të përfshira në procedurën administrative, ankuesit i cili ishte personalisht prezent dhe UBT-së, përfaqësuar nga znj. E.H , Përgjegjëse e Sektorit Juridik pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Juridike dhe znj. J.K , ish-zv.Dekane për mësimin pranë Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit, sipas autorizimit nr.2336/13 prot., datë 13.10.2025, lëshuar nga Rektori i UBT.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

4. Në vijim të seancës dëgjimore, me shkresën nr. 2336/18, datë 07.11.2025, UBT, ka depozituar qëndrimin e mëposhtëm:

Nga pala e punëdhënësit është kërkuar zhvillimi i një takimi me ankuesin, për vlerësimin e mundësive për gjetjen e një zgjidhje të përbashkët me qëllim arritjen e një pajtimi vullnetar midis palëve. Takimi i dakortësuar me ankuesin u zhvillua më datë 23.10.2025. Në përfundim të këtij takimi, gjatë të cilit u mbajt procesverbali përkatës, ankuesi shprehu mendimin që mundësia e pajtimit lidhet me kërkesën e tij që Dekani i Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit t'i kërkojë falje, që dëshmitarët të tërheqin deklaratat paraqitur para Këshillit të Etikës dhe që Rektori ti kërkojë falje publike. UBT, ndodhur në këo kushte, kur mundësia e pajtimit midis palëve nuk është e lidhur me asnjë nga rastet administrative apo procedural të paraqitura në ankim nga z. T. , por lidhet me kërkesën për falje apo tërheqje dëshmie, vlerëson se kërkesat e kësaj natyre nuk lidhen me kompetencat e institucionit, por janë kërkesa që lidhen me vendimarrje apo qendrime personale të individëve në fjalë.

UBT sjell në vëmendjen tuaj se kjo masë disiplinore e nxjerrë nga Rektori i UBT-së në cilësinë e punëdhënësit është dukshëm një masë disiplinore më e "zbutur" se masa disiplinore e marrë nga Këshilli i Etikës i cili ka vendosur për largim nga puna.

Këshilli i Etikës është një organ kolegjial dhe veprimtarinë e tij e ushtron në përputhje me parashikimet e Kodit të Etikës. Vendimarrja e Komisionit të Etikës është marrë në përputhje me vullnetin e lirë të anëtrëve të tij dhe si e tillë nuk është e ndikuar dhe kurrësi, nuk ka si të ndikohet nga asnjë ndërhyrje nga asnjë person apo autoritet i universitetit. Problematikat që z. T. ka shprehur në lidhje me procedurat e ndjekura nga KE janë të një natyre administrative, problematika që lidhen me afatet etj., por jo me element të diskriminimit. Këshilli i Etikës është një organ që e parashikon ligji i arsimit të lartë dhe ka funksionuar që prej hyrjes në fuqi të ligjit, që prej vitit 2015. Rasti i z.T. i trajtuar nga Këshilli i Etikës nuk është rasti i parë, ka shumë raste apo çështje të trajtuara nga ky Këshill Etike apo nga këshillat e mëparshëm për raste të ndryshme që lidhen me problematika të ndryshme.

Rektori i UBT-së në zbatim të parashikimeve ligjore dhe statutore pasi është njohur me vendimin e Këshillit të Etikës për dhënie mase "Largim nga detyra", pasi është njohur me gjithë procedurën e ndjekur dhe dokumentacionin e administruar, ka ushtruar gjithë të drejtën e tij ligjore si punëdhënës

dhe ka dhënë masën "Paralajmërim për largim nga puna". Ky fakt tregon qartazi një vlerësim objektiv të të gjitha rrethanave profesionale dhe personale të z.T. . Ky akt ligjor tregon më së miri se nuk ndodhemi para asnjë rasti diskriminimi apo përjashtimi të asnjë forme.

Referuar pretendimeve të ankuesit për përjashtim nga aktivitetet e brendshme institucionale që kanë të bëjnë me projektin UBT-BOKU, bazuar në përgjigjen e ardhur nga sektori i IT-së së UBT-së, ankuesi është i përfshirë në të gjitha njoftimet elektronike që lidhen me projektin në fjalë.

Projekti Strategjik "AUT 2030" në bashkëpunim me Universitetin BOKU të Vjenës, është një projekt gjithpërfshirës, në të cilin janë lutur të angazhohen dhe japing kontributin e tyre i gjithë personeli akademik i UBT-së, fakt ky jo vetëm i vërtetuar nëpërmjet mbledhjeve të vazhdueshme me Asamblenë Akademike të universitetit apo mbledhjen e Asambleve Akademike të Fakulteteve, por edhe i vërtetuar nëpërmjet komunikimeve me *e-mail* zyrtar apo edhe njoftimeve apo publikimeve në faqen zyrtare të internetit të UBT-së www.ubt.edu.al apo në faqen e rrjeteve sociale të UBT-së si Instagram, Facebook etj. Pra, në mënyrë krejt të thjeshtë që asnjë punëmarrës nuk mund të ndihet i diskriminuar apo i përjashtuar nga aktivitetet që zhvillohen në UBT, pasi aksesi në informacion për të gjitha aktivitetet, takimet apo zhvillimet është publik, transparent dhe lehtësisht i aksesueshëm për të gjithë.

Lidhur me pretendimet e ankuesit për përjashtim nga aktivitetet e brendshme akademike që kanë të bëjnë me projektin UBT-BOKU, ju bëjmë me dije se personeli akademik z. Z.T nuk ka shprehur interesin pranë Dekanatit të Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit lidhur me grupin e punës për programet e studimit pranë këtij fakulteti. Edhe në këtë rast nuk ndodhemi përpara kushteve të diskriminimit apo përjashtimit, pasi z.T. nuk ka paraqitur asnjë kërkesë zyrtare me shkrim për t'u bërë pjesë e procedurave të krijimit të grupit të punës pranë FBM-së.

Për pretenimet e ankuesit në lidhje me pagesën e orëve shtesë për vitin akademik 2023-2024, sqarojmë se vonesa në pagesë i detyrohet korrigjimeve nga ana e pedagogur z.T. si dhe pasaktësive të plotësimit të deklarimit të ngarkesës të realizuar në auditor nga ana e tij. Edhe në këtë rast nuk ndodhemi në kushtet e diskriminimit përsa kohë praktika administrative është trajtuar dhe z.T. është paguar për orët shtesë të vitit akademik 2023-2024. Vonesat në kryerjen e kësaj procedure janë të karakterit thelbësisht administrative dhe një pjesë e tyre kanë ardhur edhe si pasojë e pasaktësive në plotësimin e dokumentacionit nga vet z.T. . Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit e ka trajtuar këtë rast me seriozitetin e duhur dhe pasi ka bërë saktësimet apo verifikimet ligjore të nevojshme ka proceduar me pagesën përkatëse.

Sa i përket praktikës së ndjekur në lidhje me heqjen e ditëve të punës së pretenduar nga ankuesi për pjesmarrjen në aktivitetin e mbajtur në datat 11 dhe 12 mars 2025 në Budapest, kjo procedurë është në respektim të plotë të ligjit nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në republikën e Shqipërisë*", VKM nr.329, datë 12.04.2017 "*Për statusin e personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë*" si dhe Statutit të UBT-së të miratuar me urdhrin nr.586, datë 02.12.2024 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

UBT, thekson se praktika administrative për marrje leje lëvizje jashtë vendit për personelin akademik, është një praktikë që tashmë të paktën 5 vite që ndiqet nga i gjithë personeli akademik, pra personeli akademik si fillim duhet të bëjë kërkesën me shkrim drejtuar Përgjegjësit të Departamentit, më pas Përgjegjësi i Departamentit duhet të nënshkruaj shkresën me lëndë "Leje për lëvizje jashtë vendit" të cilën duhet ta nënshkruaj/firmosë pranojë Dekani i Fakultetit, ta miratojë Zv.Rektori për Shkencën dhe ta konfirmoj Drejtori i promovimit Akademik dhe Shkencës. Pasi të jetë nënshkruar nga të gjithë zyrtarët e mësipërm, shkresa që leje dërgohet për tu firmosur nga rektori i UBT. Pasi leja për lëvizje firmoset nga Rektori, ajo protokollohet dhe merr fuqi ligjore. Në rastin që ankohet z.T. shkresa për lëvizje jashtë vendit nuk është firmosur nga Dekani i FBM (por nga Zv.Dekani në mungesë të një autorizimi me shkrim nga Dekani), nuk është firmosur nga Drejtori i Promovimit Akademik dhe Shkencës dhe nuk është firmosur nga Zv.Rektori për Shkencën dhe as nga Rektori i UBT-së.

Pra, qartësisht edhe në këtë rast nuk jemi para kushteve të diskriminimit apo përjashtimit. Z.T. këtë procedurë administrative e njeh shumë mirë, pai ai vetë lejet për lëvizje jashtë vendit gjithmonë i ka miratuar në të njëjtën procedurë administrative, si para muajit mars 2025 ashtu edhe pas muajit mars 2025.

5. Ankuesi depozitoi pranë Komisionerit prapësimet e tij lidhur me qëndrimin e mësipërm të UBT, duke parashtruar ndër të tjera:

Rektori këtë herë, indirekt, pranon që ka patur problematika me procedurat administrative të Këshillit të Etikës por, sipas tij, këto nuk janë diskriminim. Kjo vërteton që drejtuesit e UBT nuk e vlerësojnë rëndësinë e madhe që ka procesi administrative dhe e drejta ligjore dhe kushtetuese që kanë qytetarët e Republikës së Shqipërisë për një proces ligjor të drejtë.

Rektori thotë që "*Rasti i z.T. buk është rasti i parë i trajtuar nga ky Këshill Etike.*" Në fakt nëse shikojmë dokumentacionin e sjellë, lidhur me krijimin e Këshillit të Etikës mund të arrihet në përfundimin që ky Këshill Etike u krijua posaçërisht për rastin tim. Për këtë dëshmojnë faktet në vijim: (i) Ankesa e z. Sh. është bërë më datë 27.11.2025 (ii) Datat 28 dhe 29.11.2024 kanë qenë festë zyrtare, kurse datat 30.11 dhe 1.12.2024 kanë qenë pushim fundjave. (iii) Më datë 4.12.2024 është bërë njoftimi për mbledhje senati dhe në datë 06.12.2024 është miratuar me unanimitet Këshilli i Etikës. (iv) në paraqitjen time të parë në Këshillin e Etikës, më datë 31 janar 2025, Kryetarja e Këshillit të Etikës ka pranuar që gjykimi im ishte gjykimi i parë i këtij Këshilli.

Rektori kërkon të evidentojë që, sipas tij, ai ka marrë një masë dukshëm "më të butë" nga ajo e Këshillit të Etikës, por ai nuk sqaron që: (i) Këshilli i Etikës, në bazë të Kodit të Etikës, në asnjë rast nuk mund të marrë masën më ekstreme; (ii) Ishin juristët ata që i shpjeguan Rektorit pasojat e marrjes së një mase të tillë, më saktë është neni 68 i ligjit nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", i cili përcakton: *"Largimi nga detyra i personelit akademik të IAL-së bëhet nga rektori i institucionit, me propozimin e drejtuesit të njësisë bazë, ku personeli akademik zhvillon veprimtarinë e tij dhe pas miratimit të komisionit adhoc, të ngritur nga senati akademik, në rastet e shkeljeve të rënda dhe të përsëritura të*

ligjit, sipas përcaktimit në statut dhe aktet e tjera të IAL-së". Ndërsa, si dekani dhe ish dekani arritën të ushtrojnë presion të paligjshëm ndaj anëtarëve pa eksperiencë në Këshillin e Etikës, këtë gjë nuk do të mund ta bënin me përgjegjësin e departamentit dhe me anëtarët e Komisionit *ad hoc*, i cili duhet të jetë i përbërë nga profesorë të njohur dhe me eksperiencë të gjatë. Kjo, sepse as që kemi të bëjmë fare me shkelje ligji, jo më me shkelje të rënda dhe të përsëritura; (iii) Rektori sot e kësaj dite nuk i është përgjigjur ankesës time lidhur me urdhrin e tij.

Konstatoj një mosnjohje të saktë të përcaktimit ligjor të diskriminimit nga ana e drejtuesve të UBT-së. Kështu, sipas përfaqësuesve të UBT-së, nëse ke qenë 4-5 herë jashtë shtetit dhe vetëm një herë të heqin tre ditë pune, apo nëse je njoftuar në përgjithësi për aktivitetet e UBT-së, por në tre raste specifike nuk jam njoftuar, këto nuk konsiderohen "diskriminim". Në fakt konstatohet që ka një përpjekje për të mos u dukur se ka veprime të qëllimshme. Por gjithkush mund të kuptojë që nuk mund të jetë rastësi nëse në harkun e një viti, i njëjti person, i cili më parë ka marrë vlerësimet më të larta në punë: (i) të mos i paguhen orët e mbingarkesës; (ii) t'i hiqen tre ditë punë kur përfaqësonte vendin në një aktivitet ndërkombëtar; (iii) të përjashtohet nga lista e njoftimeve në tre mbledhje të rëndësishme ku i takonte të ishte; (iv) t'i jepet masë ekstreme për largim nga puna nga një Komision Etike, i ngritur me procedura të dyshimta.

Lidhur me Këshillin e Etikës, dokumentacioni më i fundit tregon për probleme serioze të legjitimitetit të tij: (i) dokumentacioni i paraqitur nga Rektori tregon që në fakt nuk ka patur një procedurë zgjedhje të këtij këshilli. Senati Akademik ka miratuar me unanimitet një listë që është paraqitur nga Rektori; (ii) Statuti i UBT, neni 17, përcakton që pozicioni i anëtarit të Këshillit të Etikës është i papërputhshëm me asnjë pozicion drejtues në UBT. Ky përcaktim është i qartë edhe në Kodin e Etikës të UBT-së dhe Rregulloren e Këshillit të Etikës. Nëse i referohemi organigramës së sjellë nga UBT, mund të konstatojmë që janë 4 anëtarë të Këshillit të Etikës, të cilët drejtojnë njësi të ndryshme të UBT. Për pasojë, vërtetohet dyshimi i bazuar në fakte se ky Këshill Etike u ngrit me nxitim për të realizuar një mision të caktuar.

Në Këshillin e mëparshëm të Etikës (periudha 2020-2024) kishte 3 Profesorë, një Profesor i asociuar, 3 doktorë shkencash, një master shkencor dhe një student. Aktualisht në Këshillin e Etikës askush nuk ka as gradën Doktor dhe asnjëri nuk ka gradën Profesor Doktor.

Gjatë ballafaqimit në Zyrën e Komisionerit (seanca dëgjimore) përfaqësueset e UBT-së, zj. J.K dhe zj.E.H, paraqitën deklarim të rremë me qëllim dëmtimin e reputacionit tim në disa raste:

Zj. J.K :

- Kërkoi që ti paraqesë *e-mail-et* e mia si mesazhe shqetësuese për individë të cilët nuk kanë lidhje me çështjet. Në fakt të gjitha *e-mail*-et e mia janë nxitur nga situata problematike në universitet në përgjithësi dhe në programin që unë drejtoj në veçanti. Nuk është aspak e vërtetë që unë i kam shkruar pa dallim 300 vetave. Realiteti është që në intensitetin më të lartë mund të ketë pasur 1 *e-mail* në javë dhe këto *e-mail*-e janë shkruar vetëm pasi drejtuesit e UBT kanë refuzuar disa herë të përgjigjen kur ju jam drejtuar direkt atyre ose kur Departamenti ka mbetur pa përgjigje për kërkesat e tij. (Megjithatë dua të nënvizoj që e drejta e fjalës është një e drejtë

kushetetuese dhe askush nuk mund të kufizohet në të drejtët për të trajtuar probleme ashtu si ai mendon për sa kohë respekton të vërtetën dhe personalitetin e të tjerëve).

- Dha deklaratë të rreme kur tha se unë kam krahasur kolegët apo drejtuesit me kafshë. Fakti është që në *e-mail*-et e mia nuk ka asnjë rast të vetëm që unë të kem përdorur epitete për asnjë individ. Kjo vërtetohet edhe nga fakti i konfirmuar nga zj. K. që asnjë individ nuk është ankuar për një gjë të tillë.
- Deklaroi se unë u paskam shkruar për diplomimin në arkitekturë peizazhi pedagogëve të veterinarisë. Kjo nuk është e vërtetë.

Zj. E.H :

- Pretendoi që heqja e ditëve të punës ka ndodhur para fillimit të procesit në Këshillin e Etikës. Në fakt heqja e ditëve të punës ka ndodhur në Prill 2025 (paga e muajit Mars 2025) kur procesi në Këshillin e Etikës kishte nisur në Janar 2025.
- Ajo deklaroi që unë isha i vetmi që ka marrë vit sabatik gjatë 7-8 viteve të fundit. Mund të verifikohet që kjo nuk është e vërtetë.
- Në një mënyrë të pakuptimtë solli në diskutim çështjen e produktit që unë kam sjellë pas kryerjes së vitit sabatik. Fjala e saj për këtë çështje mund të trajtohet si shpifje dhe kishte qëllime denigrimi të figurës time profesionale dhe morale. Libri i përgatitur në kuadër të vitit sabatik, i pari në llojin e vet në vendin tonë, ka dy vjet që është në përdorim dhe ka marrë vlerësime të shumta pozitive.
- Ajo pretendoi se viti sabatik ishte dhënë më vonë se të fillonin debatet e mia në UBT. Ky është deklarim i rremë, lehtësisht i verifikueshëm.

Faktet e mësipërme vetëm sa shtojnë disa argumenta më shumë në mbështetje të ankesës dhe dëshmojë për diskriminimin e pandërprerë ndaj meje. Ky diskriminim zë fill me paraqitjen e kritikave të mia në prill-maj 2023, kurse në ballafaqimin e datës 14 tetor 2025 u tregua se vazhdon edhe sot e kësaj dite.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Bazuar në parashtrimet, kronologjinë e ngjarjeve dhe dokumentacionin e administruar gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vëren se:

Ankuesi Z.T , është i punësuar si staf akademik/pedagog me kohë të plotë, kategoria “Profesor”, pranë Departamentit të Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peizazhit, në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit (FBM), Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT).

Me shkresën nr. 623 prot., datë 27.11.2024, Dekani i FBM z. S.Sh , ka paraqitur pranë Rektorit të UBT z. F. S, një ankesë kundër ankuesit, duke pretenduar se ai ka shkelur rëndë Kodin e Etikës, normat elementare të komunikimit dhe sjelljes midis kolegëve dhe eprorëve, e ka kërcënuar në

ambientet e punës dhe në kohën e ushtrimit të detyrës. Kjo ankesë është administruar pranë UBT me nr.3500 prot., datë 27.11.2024.

Në këtë ankesë, Dekani i UBT pretendon se më datë 8 nëntor 2024, rreth orës 8:00, ndërkohë që ishte duke shkuar në zyrë, në katin e parë të FBM është përshëndetur me ankuesin, i cili sipas tij i kërkon duke iu imponuar që të ndalojë edhe pse ai i kishte thënë "*jam duke shkuar në zyrë se kam punë*". Dekani i UBT pretendon në ankesën e tij se, ndër të tjera në këto momente ankuesi i është drejtuar me fjalët "*I dua lekët se ti nxjerr nga rryli i fytit*". Ai parashtron se, kur i habitur nga këto fjalë i është drejtuar duke i thënë "*Z., ti po më kërcënon mua*?", ankuesi i përgjigjet "*Po unë të kërcënoj*". Sipas ankesës, dëshmitarë të ngjarjes kanë qenë z. E.I , asistent pranë Departamentit të Mbrojtjes së Bimëve dhe z. H.P , punonjës pranë FBM.

Sikurse pranohet nga të dy palët, situata e mësipërme ka ndodhur për shkak se ankuesit nuk i ishin paguar orët e mësimit si ngarkesë suplementare gjatë vitit akademik 2023-2024. Ndërsa ankuesi pretendon se pagesa e orëve mësimore si ngarkesë suplementare për vitin akademik 2023-2024, në mënyrë të padrejtë nuk ishte paguar, Dekani i FBM, pretendon se, orët e mbingarkesës së pretenduara nga ankuesi nuk ishin paguar për shkak të parregullsive të konstatuara në dokumentacionin e dorëzuar nga ankuesi në korrik 2024 dhe dokumentacioni ishte kthyer mbrapsht nga ish Dekanati i FBM, i cili kishte konstatuar këto problematika.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Juridike, i është drejtuar Rektorit të UBT me anë të një memo me nr.3500/1 prot datë 08.01.2025, duke parashtruar ndër të tjera se, bazuar në pikën 2, të nenit 9, të Kodit të Etikës, ndalohen sjelljet e dhunshme, kërcënimet, ushtrimi i dhunës fizike, sharjet, shpifjet apo veprime keqdashëse të çfarëdolloji, të kryera nga anëtarët e komunitetit universitar ndaj njëri tjetrit, dhe se sipas nenit 13 të Kodit të Etikës, është institucioni i cili shqyrton rastet e shkeljeve të normave të etikës akademike dhe profesionale. Në këtë memo, në datën 08.01.2025, Rektori i UBT ka vendosur shënimin "*Të përcillet pranë Këshillit të Etikës për tu trajtuar.*"

Me shkresën nr.3500/2 prot, datë 23.01.2025, Këshilli i Etikës ka njoftuar ankuesin se ndaj tij ka filluar procedura e verifikimit dhe shqyrtimit të ankimit në lidhje me ankimin e paraqitur nga Dekani i FBM.

Me datë 31.01.2025, Këshilli i Etikës ka zhvilluar një seancë dëgjimore me ankuesin. Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi parashtroi rrethanat që sipas tij kishin shkaktuar diskutimin e zhvilluar në datën 08.11.2024 me Dekanin e UBT duke pretenduar se, shprehjet e përdorura prej tij ishin shtrembëruar. Sipas regjistrimit audio të seancës dëgjimore të datës 31.01.2025, ankuesi ka pretenduar para Këshillit të Etikës se, shprehjet e përdorura nga ana e tij ishin "*Këto lekët e mia në rryl të fytit do t'ju ngelen*", të cilën z. Sh. e ka shtrembëruar, por thelbi i saj sipas ankuesit lidhet me shprehjen që është popullore "*Çfarë do të bësh edhe do të gjesh*", por jo prej tij, sepse ai beson në drejtësinë hyjnore. Ankuesi shprehet se, shprehja e thënë prej tij përdoret gjerësisht dhe ka kuptimin "*do të dalin nga hundët këto që ke bërë*". Ai deklaron para Këshillit të Etikës se nuk është krenar që e ka përdorur, por kjo shprehje nuk mund të konsiderohet kërcënim.

Gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, Këshilli i Etikës ka marrë dëshmitë e z. H.P , punonjës në FBM dhe E.I , asistent pranë Departamentit të Mbrojtjes së Bimëve, dekanit të FBM z. S.Sh , i cili ka ka paraqitur ankesën, z. E.K , ish Përgjegjës i Departamentit të Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peizazhit, znj. G.P , specialiste pranë Departamentit të Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peizazhit.

Me vendimin e ndërmjetëm datë 4, datë 06.02.2025, Këshilli i Etikës ka vendosur të zgjasë afatin e procedurës administrative për një periudhë 1 mujore, me arsyetimin se, nga paraqitja e pretendimeve të palëve, deklarimeve të dëshmitarëve dhe subjekteve të thirrur në seanca dëgjimore kanë rezultuar problematika të tjera të përfshira në Kodin e Etikës, për të cilat është e nevojshme që të vijojë hetimi administrativ në mbledhjen e fakteve dhe provave të tjera.

Pas zgjatjes së afatit të procedurës, Këshilli i Etikës ka administruar dëshmitë e z. I.K , ish Dekan i FBM, dhe znj. znj. E.Sh, Drejtore e Burimeve Njerëzore.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Këshilli i Etikës me vendimin nr.10, datë 07.03.2025 "*Propozim për dhënien e masës "Largim nga detyra" për z. Zydi T. për shkelje të nenit 9, pika 2 të Kodit të Etikës së Universitetit Bujqësor të Tiranës*" ka vendosur t'i propozojë Rektorit të UBT marrjen e masës "Largim nga detyra" për punonjësin Zydi T. . Nga votimi ka rezultuar se katër anëtarë votuan për propozimin e masës "Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra" dhe pesë anëtarë votuan për propozimin e masës "Largim nga detyra". Ndër të tjera në vendimin e tij nr.10, datë 07.03.2025, Këshilli i Etikës arsyeton:

"Z. T. shkruan email-e me përmbajtje kërcënuese apo shantazhuese dhe ajo që vihet re është mungesa e mënyrës zyrtare të komunikimit. Ky lloj komunikimi po kryhen nëpërmjet e-mail-it zyrtar të UBT-së që do të thotë se edhe përmbajtja duhet të ketë në brendësinë e saj elementët etikë dhe zyrtar, në rastin konkret kemi të bëjmë me një personel akademik me titullin Prof.Dr., pra me një punonjës që ka një eksperiencë të madhe dhe domosdoshmërisht duhet të dijë dhe rregullat e komunikimit. Referuar një e-mail-i të datës 20 janar , ai ju drejtohet rreth 100 punonjësve të UBT-së pra dërgimi i këtij e-mail-i nuk është se ka qëllim marrjen apo kërkimin e informacionit, por me veprimet e tij ai dëmton të prishë imazhin e Universitetit, pasi personave të cilëve u adresohen e-mail-et nuk janë në koherencë me vendimmarrjet e UBT-së, kur çdo njëri prej tyre gati çdo ditë lexon kaq shumë e-mail-e dezinformuese më pakta që ata do të mendojnë është dyshimi se çfarë po ndodh në institucion.

Dërgimi i e-maile-ve me fabula me kafshë me qëllim krahasimin e titullarëve dhe kolegëve me personazhet kafshë të librave shkon përtej shkeljes etike. Nuk është cenuar vetëm figura e drejtuesve të UBT-së por është denigruar e gjithë trupa akademike.

.....

Për sa më sipër nën optikën e deklarimeve të dëshmitarëve dhe subjekteve të thirrur në seanca dëgjimore përgjatë hetimit administrativ ka rezultuar se subjekti ndaj të cilit është bërë ankimi e ka shkelur në vijimësi Kodin e Etikës ku me veprimet e tij ai ka cenuar në mënyrë të vazhdueshme dinjitetin, personalitetin, dhe figurën profesionale të kolegëve dhe autoriteteve drejtuese. Kërcënimi i datës 8 nëntor 2024 është vetëm një ndër mënyrat e sjelljes dhe veprimeve që subjekti ka ndërmarrë.

Nga hetimi administrativ ka rezultuar se nuk kemi të bëjmë me një rast sporadik, ashtu siç ka dashur ta paraqesë subjekti edhe gjatë dhënies së sqarimeve nga ana e tij madje ka pretenduar se nuk është përdorur shprehja "I dua lekët se ti nxjerr nga rryli i fytit" por "Në rryl të fytit do të mbeten ato paratë e mia, nga hundët do të dalin", por nga deklarimet e dëshmitarëve është konfirmuar shprehja që ka pretenduar subjekti në ankesën e tij."

Në vendimin nr. 10, datë 7.3.2025, theksohet se: *"Z. H.P ka deklaruar për ngjarjen e datës 8 nëntor se ka qenë i pranishëm dhe ka dëgjuar kërcënimin e pretenduar nga ankimuesi, i artikuluar nga Prof.Dr.Zydi T. . MSC. E.I ka deklaruar për ngjarjen e datës 8 nëntor se ka patur një debat me tone të larta ku Prof.Dr.Zydi T. i kërkonte Prof.Dr. S.Sh që ti paguante orët shtesë që sipas tij i takonin dhe nuk po ja jepnin ndërsa dekani i thoshte që të qetësohej sepse nuk ja mbante njëri lekët dhe se nuk i kishte hije një sjellje e tillë. Në atë moment Prof.Dr.Zydi T. u nevrikos më shumë dhe i tha që në një mënyrë apo një tjetër ai do ti merrte ato lekë ose do t'ja hiqte fytin Prof.Dr.S.Sh ."* Sa më sipër është pasqyruar në vendimin e Këshillit të Etikës, mbështetet edhe nga deklarat me shkrim që kanë dhënë këta persona.

Në vijim të vendimit nr.10, datë 07.03.2025, të Këshillit të Etikës, nëpërmjet një relacioni shpjegues me nr. 3500/33, datë 17.03.2025, të hartuar nga strukturat e UBT, i është sugjeruar Rektorit të UBT që procedura e ndjekur kishte nevojë për plotësime dhe saktësime të mëtejshme, përpara se Rektori i UBT të vijonte me procedurat e mëtejshme. Ky relacion është miratuar nga Rektori i UBT, i cili me shkresën nr. 3500/34 prot., datë 20.03.2025, i është drejtuar Këshillit të Etikës me një kërkesë për plotësimin e vendimit të Këshillit të Etikës në këto drejtime: me një analizë të detajuar juridike; të përcaktojë në mënyrë të detajuar arsyet ligjore të mbështetura nga të dy grupet e votuesve (4 me 5); të sigurojë që vendimi të jetë i plotë dhe i mbështetur në dispozitat ligjore të zbatueshme.

Me shkresën nr.3500/35 prot., datë 27.03.2025, Këshilli i Etikës i ka kthyer përgjigje Rektorit të UBT, lidhur me plotësimin e vendimit të tij, duke parashtruar ndër të tjera:

Baza ligjore për të cilën pesë anëtarët e Këshillit të Etikës kanë votuar pro për propozimin e masës disiplinore "largim nga detyra" është:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.329, datë 12.04.2017 "*Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik*", pika 3, paragrafi i dytë që përcakton: "*Personeli akademik nuk mund të penalizohet për shkak të qëndrimeve të tij ndaj politikave të institucionit. Në të gjitha rastet, personeli akademik vepron brenda normave të etikës, në respekt të institucionit dhe kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi*". Në pikën 15 paragrafi "dh" përcaktohet si detyrë dhe përgjegjësi e personelit akademik "që të zbatojë etikën institucionale në respektim të imazhit të institucionit të arsimit të lartë dhe figurës profesionale".
- Statuti i Universitetit Bujqësor të Tiranës neni 40, pika 2, germa "i" përcakton se personeli akademik duhet "*të zbatojë etikën institucionale në respekt të Kodit të Etikës së UBT-së dhe figurës profesionale gjatë kohës së ushtrimit të veprimtarisë akademike*".
- Rregullorja e Studimeve Universitare neni 102 "*Të drejtat dhe detyrat e stafit akademik dhe atij ndihmësmësimor*", pika 2, germa "j", parashikon që detyrat e stafit akademik dhe atij

ndihmësmësimor janë: "*Të respektojë gjatë gjithë veprimtarisë së tyre parimet e etikës qytetare, duke shfaqur një figurë morale të papajtueshme me veset e këqija. Figura e pedagogut duhet të shërbejë për studentët si shembull i ndërshmërisë, largpamësisë etj. Pedagogu mban përgjegjësi për shkeljen e rregullave të vendosura. Shkelje të rregullave konsiderohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e pedagogut që cenojnë personalitetin e studentëve apo të punonjësve të tjerë të Universitetit, normat etiko-morale të mjedisit universitar apo shoqërisë*."

- Kodi i Etikës neni 9 pika 2 "*Sjellja e dhunshme ose kërcënimi, ushtrimi i dhunës fizike, sharjet, shpifjet apo veprimet keqëdashëse të çfarëdolloji, ndaj çdo anëtari të UBT-së, nga vetë anëtarët e këtij komuniteti, apo personave të lidhur me ta në lidhje martesore, lidhje gjaku e të tjera*".

Në lidhje me proporcionalitetit e masës disiplinore në raport me natyrën dhe rrethanat e shkeljes, grupi i anëtarëve të Këshillit të Etikës që kanë votuar pro masës disiplinore "largim nga detyra", kanë vlerësuar se, ankuesi ka shkelur në vijimësi Kodin e Etikës ku me veprimet e tij ka cenuar në mënyrë të vazhdueshme personalitetin dhe figurën profesionale të kolegëve dhe autoriteteve drejtuese. Sipas Këshillit të Etikës, kërcënimi i datës 8 nëntor 2024 ishte vetëm një ndër mënyrat e sjelljes dhe veprimeve që ankuesi ka ndërmarrë. Duke e konsideruar ankuesin një subjekt *recidiv* (përsëritës), pesë antëratë e Këshillit të Etikës arritën në përfundimin se është shkelur neni 9, pika 2 e Kodit të Etikës.

Në propozimin e masës disiplinore "largim nga detyra", pesë anëtarët e Këshillit të Etikës që kanë votuar pro për këtë masë disiplinore, kanë konsideruar se sjellja e ankuesit përbën shkelje flagrante të etikës dhe rregullave të universitetit, të cilat kalojnë edhe kufijtë e trajtimit etik duke përbërë shkelje penale, siç janë rastet e përsëritura të fyerjes (neni 119 i Kodit Penal). Në lidhje me këtë moment, Këshilli i Etikës thekson se, *e-mail*-et e dërguara në vazhdimësi nga ankuesi drejtuar zyrtarëve të UBT-s ka përmbajtje kërcënuese dhe shantazhuese dhe mungësë të mënyrës zyrtare të komunikimit. Këshilli i Etikës, evidenton se, dërgimi i *e-maile*-ve me fabula me kafshë me qëllim krahasimin dhe kolegëve me personazhe kafshësh të librave shkon përtej shkeljes etike. Nuk është cenuar vetëm figura e drejtuesve të UBT-së por është denigruar e gjithë trupa akademike.

Baza ligjore dhe arsyetimi i grupit të anëtarëve të Këshillit të Etikës ,të cilët kanë votuar për dhënien e masës disiplinore "*Paralajmërim për largim nga detyra*", konsiston në faktin se:

Së pari, nuk është marrë asnjë masë disiplinore ndaj subjektit as nga Departamenti apo Dekanati;
Së dyti, mosha e ankuesit, i cili është në prag pensioni;
Së treti, titulli "Nder i Universitetit" që ai ka;
Së katëri, duhet të ketë një rend progresiv në dhënien e masave disiplinore;

Me vendimin nr.23, datë 09.04.2025 të Rektorit të UBT-së "*Për dhënien e masës disiplinore "Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra" ndaj Prof.Dr.Zydi T. , staf akademik në kategorinë "Profesor" në Departamentin e Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peisazhit, pranë Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit*", është vendosur:

"1. Të jepet masa disiplinore "Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra" ndaj Prof.Dr.Zydi T. , staf akademik në kategorinë "Profesor" në Departamentin e Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peisazhit, pranë Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit, për sjellje të papërshtatshme në komunikimin institucional, si dhe përdorimin e veprimeve agresive dhe gjuhës së papërshtatshme e jo etike në korrespondencën elektronike me kolegët dhe autoritetet drejtuese, në kundërshtim me normat e etikës dhe aktet e brendshme rregullative të universitetit.
2.Në rast përsëritje të sjelljes në kundërshtim me normat e etikës institucionale, ndaj subjektit sot ë propozohet masa disiplinore "largim nga detyra", në përputhje me dispozitat e Kodit të Etikës dhe akteve të tjera rregullatore."

Në datat 11 dhe 12 mars 2025, ankuesi ka marrë pjesë në një aktivitet të zhvilluar jashtë vendit dhe konkretisht në takimin e Komitetit të Menaxhimit të Projektit CA23128: "*Connecting landscape architecture archives to enhance European landscape practice, research and education*", i zhvilluar në Budapest. Për këtë qëllim në datën 04.03.2025 ai ka paraqitur pranë Përgjegjësit të Departamentit të Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peizazhit një kërkesë për leje për të udhëtuar jashtë shtetit në këtë aktivitet, në datat 11, 12 dhe 13 mars 2025.

Së bashku me këtë dokument, është hartuar një dokument/format me lëndë "Leje për lëvizje jashtë vendit". Ky dokument është sigluar nga ana e Përgjegjësit të Departamentit z. Gj.V dhe është marrë nga ankuesi për të vijuar më tej me procedurën e miratimit nga oranet eprore të UBT. Rezulton se kërkesa për leje është firmosur për llogari të Dekanit të FMB z. S.Sh nga znj. L.P , e cila mban funksionin e Zv.Dekanes në FBM. Deri në datën 10.03.2025, nuk është bërë e mundur që leja të nënshkruhej nga të gjitha strukturat e tjera eprore të UBT, përfshi Rektorin e UBT. Procedura për nënshkrimin e kërkesës për leje nuk është përfunduar me të gjitha nënshkrimet për t'u konsideruar e miratuar, por nga ana tjetër strukturat përgjegjëse që duhet të miratonin ose jo lejen e kërkuar, nuk kanë dalë me një akt për refuzimin e lejes. Në këto kushte ankuesi ka vijuar dhe ka marrë pjesë në këtë aktivitet.

Në datën 02.04.2025, përpara plotësimit të listprezencës së Departamentit të Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peizazhit, Përgjegjësi i Departamentit ka kërkuar një interpretim ligjor nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Juridike mbi procedurën që duhet të ndiqte për regjistrimin e ditëve të listëprezencës mujore për muajin mars 2025 për ankuesin, në kushtet kur procedura për marrjen e lejes për udhëtim jashtë vendit ishte nënshkruar dhe miratuar nga Përgjegjësi i Departamentit dhe për llogari të Deganit nga Zv.Dekania, nuk ishte përmbyllur nga strukturat e tjera eprore.

Në përgjigje të kësaj kërkesë për interpretim të bërë nga Përgjegjësi i Departamentit të Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peizazhit, me shkresën nr. 1132/1 prot datë 03.04.2025, të Administratorit të UBT, është vlerësuar se, kërkesa për leje, nuk përmbante elementët formalë që një shkresë zyrtare duhet të ketë, konkretisht mungon numri i protokollit, data, firma dhe vula. Si i tillë dokumenti i quajtur "kërkesë për leje" nuk ka formën e një kërkese zyrtare të vlefshme për procedurën administrative. Gjithashtu në këtë përgjigjegje evidentohet fakti se, nënshkrimi nga ana e z. L.P, për llogari të Dekanit të FBM, nuk shoqërohet me ndonjë urdhër ose dokument zyrtar që e autorizon atë

të firmosë në emër të Dekanit. Për të konsideruar verifikimin dhe regjistrimin e saktë të ditëve të prezencës mujore për ankuesin është kërkuar: - miratimi zyrtar nga drejtuesi i njësisë kryesore (Dekani i FBM), hartuar dhe protokolluar sipas formatit standard të universitetit; - informimi zyrtar drejtuar Rektorit, sipas parashikimeve të VKM-së në fuqi.

Me shkresën nr. 234 prot., datë 03.04.2025, Dekani i FBM informon se, pranë Dekanatit të FBM nuk ka patur kërkesë nga z. Zydi T. që leje që miratohet nga Drejtuesi i Njësisë Kryesore, sipas procedurave të parashikuara nga VKM nr.329/2017.

Me shkresën nr. 8 prot datë 03.04.2025, Përgjegjësi i Departamentit të Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peizazhit, ka përcjellë pranë Financës së FBM, listëprezencën për muajin maj 2025, ku ankuesi pasqyrohet në mungesë për datat 11, 12 dhe 13 mars 2025.

- *Në lidhje me mospagesën e orëve të mësimit si ngarkesë suplementare gjatë vitit akademik 2023-2024, bazuar në faktet dhe provat të cilat rezultuan të provuara gjatë shqyrtimit të ankesës, konstatohet se:*

Në përmbyllje të aktiviteteve mësimore për vitin 2023-2024, ka rezultuar që ngarkesa faktike e ankuesit ka qenë më e lartë se ngarkesa e planifikuar. Përgjegjësi i Departamentit në atë kohë z. E.K , ka konstatuar parregullsi në dokumentacionin e depozituar nga ana e ankuesit në lidhje me pagesën e mbingarkesës dhe në kushtet kur ankuesi nuk ka pranuar të kryejë rregullimet e kërkuara, Përgjegjësi i Departamentit nuk e ka përcjellë emrin e ankuesit për kryerjen e pagesës në muajin korrik 2024. Gjatë muajit korrik 2024, në një komunikim me ish Zv. Dekanen e FBM, znj. K., ankuesi sërisht nuk ka pranuar të bëjë rregullimet e kërkuara në lidhje me mospërputhjet e konstatuara midis ngarkesës faktike dhe asaj të planifikuar.

Gjatë muajit shtator 2024, ankuesi ka patur komunkim me Përgjegjësin e Departamentit (*email* datë 9 dhe 11 shtator 2024, në lidhje me këtë çështje, duke pretenduar se ka paraqitur mësimin e bërë realisht.

Nëpërmjet një kërkese të datës 12.9.2024, ankuesi i është drejtuar Përgjegjësit të Departamentit z. V. për zhbllokimin e pagesave të orëve të mbingarkesës.

Nëpërmjet *e-mail*-it të datës 18.9.2024, Dekani i FBM, z. Sh, i kthen përgjigje Përgjegjësit të Departamentit se duhet të ribëhen dokumentat e ngarkesës mësimore duke refletuar vërejtjet e ish Zv.Dekanes dhe të kalojnë në procedurë.

Në datën 30.9.2024, ankuesi ka paraqitur një kërkesë për ndryshime në tabelat e ngarkesës mësimore për vitin akademik 2023-2024.

Me shkresën nr.535 prot., datë 5.11.2024, të Dekanit të FBM, ankuesi është informuar se dokumentacioni i tij në lidhje me ngarkesën faktike për vitin akademik 2023-2024, përmban sërish parregullsi dhe mospërputhje.

Me shkresën nr.53 prot., datë 8.11.2024, Përgjegjësi i Departamentit z. V, i ka përcjellë Dekanit të FBT z.Sh, sqarimin e bërë nga ankuesi në lidhje me parregullsitë dhe mospërputhjet e konstatuara sipas shkresës nr. 535 prot. datë 5.11.2024. Nuk rezulton që pas kësaj shkrese, ankuesi të ketë reflektuar ndryshime lidhur me mospërputhjet dhe parregullsitë e konstatuara.

Gjatë muajit shkurt 2024, ankuesi ka paraqitur në Këshillin e Etikës një ankesë në lidhje me mospagesën e mbingarkesës mësimore për vitin akademik 2023-2024. Kjo ankesë është marrë në shqyrtim nga Këshilli i Etikës. Në përfundim të shqyrtimit të saj, Këshilli i Etikës me shkresën e datës 9.5.2025 (nr.3500/43 prot., datë 12.5.2025) ka informuar ankuesin se duhet të reflektohen korrigjimet në paraqitjen e ngarkesës faktike për vitin akademik 2023-2024 dhe të vijohet me procedurat administrative financiare.

Në datën 30.4.2025, ankuesi ka bërë rregullimet e kërkuara me shkresën nr.535 prot datë 5.11.2024, në lidhje me ngarkesën suplementare për vitin akademik 2023-2024 dhe me shkresën nr.16 prot. datë 30.4.2025, të Përgjegjësit të Departamentit, procedura e pagesës së orëve të mbingarkesës është përcjellë pranë Dekanit të FBM.

Me shkresën nr.405 prot., datë 12.5.2025, të Dekanit të FBM, dokumentacioni për pagesën e orëve suplementare për vitin akademik 2023-2024, është përcjellë pranë Administratorit të FBM.

Bazuar në urdhër shpenzimin nr.69 datë 22.5.2025, rezulton se ankuesit i janë paguar orët suplementare për vitin akademik 2023-2024. Sëbashku me ankuesin rezulton se është kryer pagesë e prapambetur e orëve suplementare për vitin akademik 2023-2024 edhe për një tjetër punonjës të UBT.

Ankuesi ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën nr. 129, datë 28.05.2025, duke pretenduar se është diskriminuar nga UBT për shkaqet e pretenduara të diskriminimit.

Bazuar në faktet dhe kronologjinë e ngjarjeve të parashtruara më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri ka arritur në përfundimet e mëposhtme, mbi pretendimet për diskriminim të parashtruara nga ankuesi:

- *Në lidhje me pretendimet e ankuesit për diskriminim ndaj programit të studimit "Arkitekturë Peizazhi".*

Komisioneri vlerëson se, pretendimet e ankuesit në lidhje me diskriminimin ndaj programit të studimit"Arkitekturë Peizazhi", që sipas ankuesit ka si shkak të pretenduar diskriminimi *"xhelozinë e programeve tradicionale"*, një pjesë e të cilave, megjithë mbështetjen e veçantë që marrin nuk kanë qenë të suksesshëm vitet e fundit dhe nga ku vijnë Drejtuesit kryesorë të Universitetit Bujqësor të Tiranë, janë pretendime që nuk mund të merren në shqyrtim nga Komisioneri, për dy arsye:

Së pari, për shkak të mungesës së legjitimitetit aktiv të ankuesit. Bazuar në pretendimet e paraqitura nga ankuesi nuk konstatohet se ankuesi ka një interes legjitim personal. Programi i studimit "Arkitekturë Peizazhi" nuk është një e drejtë që i përket ankuesit, por është një program studimi i UBT.

Së dyti, për shkak se, subjekti që ankuesi pretendon se është diskriminuar, pra programi i studimit "Arkitekturë Peizazhi" nuk përfshihet në rrethin e subjekteve që gjejnë mbrojtje sipas LMD. Programi i studimit "Arkitekturë Peizazhi", në kuptim të nenit 4, të LMD, nuk është një individ, person fizik ose person juridik, apo një subjekt i të drejtës me personalitet juridik të veçantë. Ai është një program studimi i cili i përket dhe ofrohet nga UBT. Sipas nenit 6, pika 22, të ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", "programi i studimit" është një tërësi veprimtarish akademike dhe/ose kërkimore shkencore, përfundimi me sukses i të cilave i jep të drejtën studentit të pajiset me një certifikatë, diplomë ose gradë shkencore prej institucionit të arsimit të lartë që e ofron atë, në varësi të llojit të programit të studimit.

- *Në lidhje me pretendimin e ankuesit se është diskriminuar për shkak se është penguar padrejtësisht udhëheqja e punimeve të diplomës së studentëve të masterit profesional në vitin akademik 2023-2024.*

Komisioneri vlerëson se, pretendimi është i paqartë dhe nuk paraqitet asnjë shpjegim se cilat janë veprimet ose mosveprimet e pretenduara si diskriminuese dhe si është cenuar ankuesi.

- *Në lidhje me pretendimin e ankuesit se është diskriminuar duke u përjashtuar dhe margjinalizuar nga aktivitet e brendshme institucionale dhe akademike.*

Fillimisht në momentin e paraqitjes së ankesës, pretendimi i ankuesit për diskriminim, si pasojë e përjashtimit nga aktivitetet e brendshme institucionale dhe akademike, konsistonte në, mosnjoftimin për takimin e datës 20 mars 2025. Ankuesi pretendon se, ai ka kërkuar sqarime se pse Rektori nuk ka reaguar për *e-mailet* e tij të datës 20.03.2025 dhe 22.04.2025, nëpërmjet të cilave ai është njohur me mungesën e njoftimeve, por nuk ka marrë përgjigje.

Nga aktet e administruara rezulton se me *e-mail* datë 17.03.2025, nga adresa aut-boku@ubt.edu.al, është dërguar një *email* i cili njofton se, në datën 20.03.2025, në orën 10:30 – 12:30, do të zhvillohet një takim me Ekipin e Projektit BOKU, takim i cili i dedikohet të gjithë stafit të UBT-së të kategorisë Prof.Dr. dhe Prof.Ass për të diskutuar për çështje të ndryshme. Ky *email* është dërguar në grup në adresën asc2@ubt.edu.al me emërtimin "Academic Staff " (Proff. Dr. & Prof.Ass.)

Në prapësimet e paraqitura gjatë shqyrtimit të ankesës, ankuesi parashtron se, ai është përjashtur edhe nga takimet e datës 29.01.2025 dhe 01.07.2025.

Nga aktet e administruara rezulton se, me e-*mail* datë 21.01.2025, nga adresa aut-boku@ubt.edu.al, është dërguar një e-*mail* i cili njofton se në datën 29.01.2025, ora 09:30 – 11:30, do të zhvillohet një

takim i hapur me të gjithë stafin e UBT-së në kuadër të misionit të radhës së Ekipit BOKU në UBT. Ky *e-mail* është dërguar në grup në adresën aut@ubt.edu.al me emërtimin "AUT Staff".

Ankuesi pretendon se nuk ka qenë pjesë e *e-mailit* nëpërmjet të cilit është njoftuar takimi i datës 20.03.2025, dhe në datë 20.03.2025 i është drejtuar me *email* Rektorit të UBT-së dhe z. M.R, i cili rezulton të jetë Menaxher i Projektit. Në datë 22.04.2025 ankuesi iu është drejtuar sërisht, pasi nuk ka marrë përgjigje.

Komisioneri merr në shqyrtim vetëm ato pretendime që janë ngritur në ankesë ose fakte që kanë lidhje me këto pretendime, por që kanë ndodhur deri në momentin e paraqitjes së ankesës. Objekti i ankesës pranë Komisionerit nuk mund të shtohet me pretendime ose fakte që ndodhin pas momentit që ankesa është paraqitur për shqyrtim pranë Komisionerit. Për sa më sipër, pretendimi i ankuesit për takimin e datës 01.07.2025, nuk mund të merret në shqyrtim.

Për të provuar pretendimin se nuk është njoftuar për takimet e datës 29.01.2025 dhe 20.03.2025, ankuesi ka depozituar *e-mail*-et e përcjella "*forwarded message*" nga ana e z. Gj.V, Përgjegjës i Departamentit. Ndërsa UBT, parashtroi gjatë shqyrtimit të ankesës se, me shkresën nr.2326/5 prot., datë 11.07.2025, të Përgjegjësit të Zyrës së Teknologjisë së Informacionit në UBT, konfirmohet se në komunikimet zyrtare të kryera nga adresa institucionale e projektit UBT-BOKU 2030, z. Z.T ka qenë i përfshirë në njoftimet elektronike që lidhen me projektin në fjalë. Adresa e tij e *e-mail-it* bën pjesë në grupet zyrtare të komunikimit si: Stafi Akademik, Stafi Akademik me titull Prof.Dr., Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit, Stafi AUT, News, Partnerët UBT.

Komisioneri vlerëson se, faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, janë të pamjaftueshme për të arritur në përfundimin se, ankuesi është përjashtuar dhe margjinalizuar nga aktivitet e brendshme institucionale dhe akademike. Në arritjen e këtij përfundimi, Komisioneri mban në konsideratë edhe faktin se takimet kanë qenë takime të hapura dhe se çështjet e trajtuara ose objekti i këtyre takimeve, nuk rezulton që të ketë sjellë ndonjë cenim në të drejta për ankuesin. Gjithashtu, edhe nëse pranohet se ankuesi nuk është njoftuar për këto takime sipas njoftimeve elektronike në grup, rezulton se ai ka marrë dijeni dhe se vetëm mungesa e njoftimit për këto dy takime, takime të cilat nuk kanë sjellë ndonjë cenim në të drejtat e ankuesit, nuk mund të çojë në përjashtim dhe margjinalizim.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se ankuesi nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm nga ana e UBT-së, në lidhje me pretendimin për përjashtim dhe margjinalizim nga aktivitet e brendshme institucionale dhe akademike.

- *Në lidhje me diskriminimin e pretenduar si pasojë e mospagesës së orëve të mësimit si ngarkesë suplementare gjatë vitit akademik 2023-2024.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, në muajin maj 2025, ankuesit i janë paguar orët suplementare për vitin akademik 2023-2024. Në këto kushte, në momentin e paraqitjes së ankesës në datën 28.05.2025, rezulton se ky pretendim i ngritur në ankesë ka mungesë të objektit, për sa kohë

që, pagesa e orëve suplementare për vitin akademik 2023-2024 i është paguar ankuesit nga ana e UBT-së, para se ai të paraqiste ankesën.

Ankuesi pretendon se nuk ka marrë sqarime për një sërë çështjes dhe shkresash që ka adresuar ndaj strukturave drejtuese të UBT-së në lidhje me mospagimin e orëve mësimore suplementare për vitin akademik 2023-2024 dhe se, procesi u rihap vetëm në mars 2025, pas ankesës së tij në këshillin e Etikës në muajin shkurt 2025.

Bazuar në aktet dhe provat e administruara, rezultoi e provuar se, procesi për pagesën e orëve suplementare për vitin akademik 2023-2024 nuk rezulton në asnjë moment që të jetë mbyllur me një refuzim për mospagimin e tyre. Nga e gjithë korrespondenca e mbajtur në lidhje me këtë çështje, rezulton e provuar se përmbyllja e procesit për kryerjen e pagesës është kushtëzuar nga fakti që në dokumentacionin e depozituar nga ankuesi në lidhje me këtë çështje janë konstatuar pasaktësi dhe mospërputhje që e bënin të pamundur kryerjen e pagesës. Gjatë shqyrtimit rezultoi e provuar se, në mënyrë të vazhdueshme qoftë nëpërmjet komunikimeve formale dhe jo formale, në mënyrë elektronike (me e-mail) dhe me anë të shkresave zyrtare ankuesit i është bërë me dije që pagesa kushtëzohej nga rregullimi i pasaktësive dhe mospërputhjeve të konstatuara në dokumentacionin e tij.

Nga komunikimet e realizuara në lidhje me këtë çështje, Komisioneri vlerëson se, UBT nuk ka qendruar pasiv dhe indiferent, për zgjidhen e problematikës. Rezulton se, në datën 30.04.2025, në momentin që ankuesi ka rregulluar dokumentacionin e kërkuar, procedura e pagesës së orëve suplementare ka përfunduar në muajin maj 2025.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se ankuesi nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm nga ana e UBT-së, në lidhje me pretendimin e mospagesës së orëve suplementare të mësimit për vitin akademik 2023-2024.

- *Në lidhje me diskriminimin e pretenduar si pasojë e heqjes së tre ditëve punë për datat 11, 12, dhe 13 mars 2025, për shkak të pjesëmarrjes në një aktivitet të zhvilluar jashtë shtetit.*

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 12.4.2017 "*Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik*" (VKM nr.329/2017), në pikën 12, të tij përcakton: *"Personeli akademik, për aktivitete që lidhen me drejtimet e punës së tij, sipas pikës 2, të këtij vendimi, ka të drejtën e përfitimit të një leje deri në dy javë, me miratim nga drejtuesi i njësisë kryesore, që informon, në çdo rast, rektorin. Për kohëzgjatje mbi dy javë, leja merret nga rektori. Në të gjitha rastet, kërkesat për leje duhet të jenë të dokumentuara dhe të justifikuara. Personeli akademik raporton përpara departamentit mbi aktivitetin e kryer gjatë lejes."*

Sipas VKM-së së sipërcituar, për të përfituar leje deri në dy javë, personeli akademik duhet të marrë miratimin e drejtuesit të njësisë kryesore, pra të Dekanit të Fakultetit dhe ky i fundit informon në çdo rast Rektorin.

Gjatë shqyrtimit rezultoi se procedura për marrjen e lejes për lëvizjen e personelit akademik jashtë vendit, nuk është e rregulluar në ndonjë akt të shkruar. Sipas shpjegimeve të palëve, rezulton se praktika administrative që ndiqet për marrjen e lejes për lëvizje jashtë vendit për personelin akademik është si vijon:

Personeli akademik si fillim duhet të bëjë kërkesën me shkrim drejtuar Përgjegjësit të Departamentit, më pas Përgjegjësi i Departamentit duhet të firmosë shkresën me lëndë "Leje për lëvizje jashtë vendit" të cilën duhet ta firmosë Dekani i Fakultetit, ta miratojë Zv.Rektori për Shkencën dhe ta konfirmoj Drejtori i Promovimit Akademik dhe Shkencës. Pasi të jetë nënshkruar nga të gjithë zyrtarët e mësipërm, shkresa për leje dërgohet për t'u firmosur nga Rektori i UBT. Pasi leja për lëvizje firmoset nga Rektori, ajo protokollohet dhe merr fuqi ligjore.

Sipas shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore nga përfaqësuesit e UBT-së, procedura apo lëvizja e shkresës për leje, kryhet nga ana e personit që kërkon të marrë leje. Pra, është kërkuesi i lejes ai që pas paraqitjes së kërkesës për leje duhet ta lëvizë ai shkresën tek të gjithë personat të cilët sipas procedurës duhet të miratojnë duke nënshkruar lejen për të lëvizur jashtë shtetit. Pas depozitimit të kërkesës për leje, ajo nuk qarkullon zyrtarisht brenda strukturave të UBT-së, në mënyrë që çdo subjekt i cili duhet të japë miratimin e tij të bëjë vlerësimin e tij duke e konfirmuar lejen ose duke e refuzuar atë. Siç, rezulton edhe nga shpjegimet e e UBT në lidhje me ndjekjen e praktikës administrative për marrjen e lejes, shkresa me lëndë "Leje për lëvizje jashtë vendit", që është formati që përdoret në këtë rast, protokollohet dhe merr fuqi ligjore pasi firmoset nga Rektori.

UBT parashtroi gjatë shqyrtimit të ankesës, se në rastin që ankohet z.T. , shkresa për lëvizje jashtë vendit nuk është firmosur nga Dekani i FBM, por nga Zv.Dekani në mungesë të një autorizimi me shkrim nga Dekani, nuk është firmosur nga Drejtori i Promovimit Akademik dhe Shkencës dhe nuk është firmosur nga Zv.Rektori për Shkencën dhe as nga Rektori i UBT-së.

Bazuar në provat e administruara rezulton se, ankuesi ka depozituar në datën 4.03.2025 kërkesën për leje pranë Përgjegjësit të Departamentit, më pas ky i fundit ka nënshkruar shkresën "Lejë për lëvizje jashtë vendit". Gjithashtu rezulton se, kjo shkresë është nënshkruar nga znj. L.P, e cila është Zv.Dekane në FBM. Ndërkohë rezulton se shkresa për leje nuk është firmosur nga strukturat e tjera përgjegjëse. Sipas ankuesit ka qenë e pamundur që personat të kontaktoheshin dhe të firmosnin dhe deri ditën e fundit të paraqitjes së tij në punë para se të nisej për aktivitetin jashtë vendit ai nuk ka mundur që të marrë firmat e tyre. Sipas shpjegimeve të dhëna nga Përgjegjësi i Departamentit z. V., me shkresën nr. 7 prot., datë 2.4.2027, procedura e lejes ka mbetur pezull për shkak të mosfirmosjes nga Zv.Rektorja e cila nuk është mundur të kontaktohet. Ai deklaron se, është kontaktuar edhe sekretariati i Rektoratit, por nuk është mbajtur shkresa për t'ia dorëzuar Zv.Rektores.

Bazuar në VKM nr.329/2017, nënshkrimi i lejes apo miratimi nga ana e Zv.Rektorit për Shkencën dhe konfirmimi nga Drejtori i Promovimit Akademik dhe Shkencës, nuk parashikohet. Gjithashtu, rezulton se procedura administrative që zbatohet në UBT për marrjen e lejes, nuk është e rregulluar në ndonjë akt të shkruar por është një praktikë administrative që zbatohet e tillë prej rreth 5 vitesh.

Komisioneri vlerëson se, në momentin që ankuesi ka paraqitur kërkesën për leje, qarkullimi i saj nuk mund të kryhet nga ana e vetë personit, pra nga ana e ankuesit, por duhet që qarkullimi nëpër strukturat përgjegjëse që duhet të nënshkruajnë, të miratojnë ose refuzojnë kërkesën, duhet të bëhet zyrtarisht nga administrata e UBT. Ankuesi, nuk mund të disponojë aktet apo autorizimet e institucionit. Për sa kohë që shkresa është nënshkruar nga Zv.Dekania e FBM, i takon strukturave të UBT që në rast se Zv.Dekania, nuk ka patur autorizim nga Dekani për të nënshkruar kërkesën për leje, duhet ta kishte refuzuar procedurën për këtë shkak. Por në çdo rast është UBT që duhet të kryjë verifikimin në rast se pretendon se Zv.Dekania nuk ka patur autozim për të nënshkruar.

Autoritetet të cilat ligji i ngarkon me kompetenca të caktuara kanë detyrimin që ti ushtrojnë ato. Pra, në kushtet që provohet se ankuesi e ka depozituar ankesën pranë Përgjegjësit të Departamentit, sikurse kërkohet sipas praktikës administrative që zbatohet në UBT për marrjen e lejes, i takon strukturave të UBT që të qarkullojnë kërkesën dhe personat përgjegjës kanë detyrimin që të miratojnë ose refuzojnë në mënyrë të justifikuar, kërkesën për leje. Në rastin e ankuesit, nuk ka një refuzim zyrtar të kërkesës për leje, por procedura është lënë pa veprime. Nëse Zv.Dekania e FBM nuk kishte autorizimin për të firmosur në emër të Dekanit të FBM, është në detyrimin e UBT, që të refuzonte kërkesën për këtë arsye, por nuk mund të ngarkojë ankuesin me detyrimin që duhet ta shoqërojë shkresën e lejes me autorizimin e Dekanit për Zv.Dekanen që ka nënshkruar. Për sa kohë që, provohet se ankuesi ka depozituar kërkesën për leje dhe UBT nuk e ka refuzuar atë por e ka lënë pa veprime, rrjedhimisht UBT e ka miratuar në heshtje kërkesën e lejes. Në këto kushte, heqja e ditëve të punës për datat 11, 12, dhe 13 mars 2025, për shkak të pjesmarrjes në një aktivitet jashtë vendit, është i pabazuar.

Sa më sipër Komisioneri arrin në përfundmin se, ankuesi i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm nga ana e UBT, në lidhje me heqjen e ditëve të punës për datat 11, 12, dhe 13 mars 2025, për shkak të pjesmarrjes në një aktivitet jashtë vendit.

- *Në lidhje me procedimin disiplinor për dhënien e masës disiplinore "Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra"* .

Ankuesi pretendon se, procedimi disiplinor për dhënien e masës disiplinore "vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra", me vendimin nr.23, datë 9.4.2025, të Rektorit të UBT-së, ka një sërë shkeljesh procedurale si: 1. Shkelje të afateve procedurale, 2. Mungesë e shkresës zyrtare për fillimin e çështjes nga Këshilli i Etikës; 3. Konflikt interesi të Kryetares së Këshillit të Etikës; 4. Mungesë e vendimit të ndërmjetëm nga organi publik kompetent për marrjen e vendimit përfundimtar; 5. Probleme me dëshmitarët dhe dëshmitë; 6. Mungesë e vendimit të Senatit Akademik të Universitetit Bujqësor të Tiranës; 7. Mungesë e njoftimit për vendimin përfundimtar të Këshillit të Etikës nr.10. datë 7.3.2025 dhe rrjedhimisht procedimi disiplinor i zhvilluar nga Komisioni i Etikës dhe vendimi i tij i datës 7.3.2025, si dhe vendimi nr.23, datë 9.4.2025 i Rektorit të UBT për dhënien e masës disiplinore është i pavlefshëm.

Komisioneri thekson se nuk është në kompetencën e tij që të konstatojë pavlefshmërinë e një akti administrativ. Bazuar në LMD, Komisioneri ka kompetencë që të konstatojë nëse kemi të bëjmë me

sjellje diskriminuese në kuptim të këtij ligji, pra nëse ankuesi i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm, ky trajtim ka ndodhur për shkakun e pretenduar të diskriminimit, shkak i cili duhet të gëzojë mbrojtje ligjore, dhe nuk ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e diferencuar dhe të disfavorshëm të cilit ankuesi i është nënshtruar. Për të arritur në konkluzionin nëse kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese, Komsioneri vlerëson sjelljen e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa në raport me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi, por konstatimi i veprimeve në kundërshtim me ligjin nuk është automatikisht i barazvlefshëm me trajtimin e padrejtë dhe të disfavorshëm. Sjella diskriminuese është një veprim që vjen në kundërshtim me ligjin, por jo çdo paligjshmëri përbën diskriminim.

Gjatë shqyrtimit rezultoi e provuar se, ankesa e paraqitur nga Dekani i FBM në datën 27.11.2024, është përcjellë nga Rektori i UBT-së në tejkalim të afatit 5 ditor të parashikuar nga neni 13, pika 4, të Kodit të Etikës. Këshilli i Etikës në UBT është ngritur me vendimin nr. 40, datë 6.12.2024, të Senatit Akademik të UBT-së, ndërsa ankesa është përcjellë pranë tij nga Rektori i UBT-së në datë 8.1.2025.

Për sa i përket pretendimit të ankuesit se nuk ka shkresë zyrtare për fillimin e çështjes nga Këshilli i Etikës, nga aktet e administruara rezulton se, në memon nr.3500/1 prot, datë 8.1.2025, të Drejtores së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Juridike, ka vendosur shënimin në të njëjtën datë "*Të përcillet pranë Këshillit të Etikës për tu trajtuar*". Në Kodin e Etikës, nuk ka ndonjë rregullim të posaçën në lidhje me mënyrën se si duhet të përcillet ankesa pranë Këshillit të Etikës. Shënimi i datës 8.1.2025, në mënyrë të qartë pasqyron vullnetin e Rektorit të UBT-së për të përcjellë ankesën pranë Këshillit të Etikës. Në këto kushte, pretendimi i ankuesit nuk është i bazuar. Bazuar në praktikat e administruara, konstatohet se vendosja e shënimeve mbi aktet ose shkresat, është një praktikë që ndiqet nga UBT dhe nuk është zbatuar vetëm në rastin e shënimit të vendosur në memon e datës 8.1.2025, për përcjelljen e ankesës për trajtim në Këshillin e Etikës.

Sa i takon pretendimit të ankuesit për ekzistencën e konfliktit të interesit të Kryetares së Këshillit të Etikës znj. J.K , për shkak se kjo e fundit ka qenë Zv.Dekane për mësimin në FBM dhe ka qenë e para që sipas ankuesit ka penguar pagesën e mbingarkesës që përbën shkakun e konfliktit me Dekanin e FBM z. Sh. , Komisioneri gjykon se, ankesa e cila është shqyrtuar nga Këshilli i Etikës nuk ka patur si objekt çështjen e pagesës së orëve të mbingarkesës por sjelljen jo etike që pretendohet se ka treguar ankuesi në datën 8.11.2024 ndaj Dekanit të FBM. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se nuk ka vend për konfliktin e pretenduar të interesit nga ana e ankuesit.

Në lidhje me pretendimin për mungesë të vendimit të Senatit Akademik të Universitetit Bujqësor të Tiranës, rezulton se një detyrim i tillë buron vetëm në rast të marrjes së masës disiplinore për largimin nga puna. Kjo gjen rregullim në nenin 68, të ligjit nr. 80/2025, ku parashikohet: ".....*2. Largimi nga detyra i personelit akademik të IALsë bëhet nga rektori i institucionit, me propozimin e drejtuesit të njësisë bazë, ku personeli akademik zhvillon veprimtarinë e tij dhe pas miratimit të komisionit adhoc, të ngritur nga Senati Akademik, në rastet e shkeljeve të rënda dhe të përsëritura të ligjit, sipas përcaktimeve në statut dhe në aktet e tjera të IAL-së."*

Me vendimin nr. 4, datë 06.02.2025, Këshilli i Etikës ka zgjatur afatin e procedurës administrative që duhet të zhvillohet nga ana e këtij organi, i cili është përgjegjës për marrjen e vendimit propozues për marrjen e masës disiplinore. Sipas pikës 3, të nenit 13, të Kodit të Etikës, Rektori ka të drejtën të kërkojë zgjatjen e afatit të hetimit nga Këshilli i Etikës, pas marrjes së vendimit nga Këshilli i Etikës, në rast se konstaton mungesën e zhvillimit të një procedure të plotë për verifikimin dhe shqyrtimin e çështjes. Në këtë rast, Këshilli i Etikës ka zgjatur afatin, në cilësinë e organit i cili do të marrë vendimin për propozim të masës disiplinore.

Me vendimin nr.4, datë 6.2.2025, Këshilli i Etikës nuk ka zgjatur vetëm afatin e procedurës por ka shtuar edhe objektin e procedurës administrative në lidhje me fakte dhe rrethana që nuk përfshihen në ankesën në shqyrtim. Faktet dhe rrethanat e shtuara në objektin e ankesës, Këshilli i Etikës i ka konsideruar si shkelje të përsëritura të etikës. Komisioneri vlerëson se, Këshilli i Etikës nuk mund të shtojë objektin e ankesë me fakte dhe rrethana të cilat nuk ngrihen dhe nuk janë objekt i ankesës. Komisioni i Etikës kishte detyrimin që të shqyrtonte dhe të shprehej vetëm mbi objektin e ankesës.

Në vendimin për propozimin e masës administrative "Paralajmërim për largim nga detyra", Këshilli i Etikës vlerëson se, shkelja e konsumuar nga ankuesi parashikohet nga neni 9, pika 2, të Kodit të Etikës, ku parashikohet:

Kodi i Etikës neni 9 "Sjelljet e ndaluara" pika 2 parashikon: " *Sjelljet e ndaluara të cilat përbëjnë shkelje të rënda të Kodit të Etikës, përfshijnë: ....2. Sjellja e dhunshme ose kërcënimi, ushtrimi i dhunës fizike, sharjet, shpifjet apo veprimet keqëdashëse të çfarëdolloji, ndaj çdo anëtari të UBT-së, nga vetë anëtarët e këtij komuniteti, apo personave të lidhur me ta në lidhje martesore, lidhje gjaku e të tjera*".

Këshilli i Etikës arsyeton se, ankuesi ka shkelur në vijimësi Kodin e Etikës, ku me veprimet e tij ka cenuar në mënyrë të vazhdueshme personalitetin dhe figurën profesionale të kolegëve dhe autoriteteve drejtuese, duke e konsideruar atë një subjekt *recidiv*. Sipas Këshillit të Etikës, kërcënimi i datës 8 nëntor 2024 ishte vetëm një ndër mënyrat e sjelljes dhe veprimeve që ankuesi ka ndërmarrë. Këshilli i Etikës ka konsideruar se sjellja e ankuesit përbën shkelje flagrante të etikës dhe rregullave të universitetit, të cilat kalojnë edhe kufijtë e trajtimit etik duke përbërë shkelje penale siç janë rastet e përsëritura të fyerjes (neni 119 i Kodit Penal). Në lidhje me këtë moment, Këshilli i Etikës thekson se, janë pikërisht *e-mail*-et e dërguara në vazhdimësi nga ankuesi drejtuar zyrtarëve të UBT-s, të cilat kanë përmbajtje kërcënuese dhe shantazhuese dhe mungësë të mënyrës zyrtare të komunikimit. Këshilli i Etikës, evidenton se, dërgimi i *e-maile*-ve me fabula me kafshë me qëllim krahasimin dhe kolegëve me personazhe kafshësh të librave që shkon përtej shkeljes etike. Nuk është cenuar vetëm figura e drejtuesve të UBT-së por është denigruar e gjithë trupa akademike.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, UBT nuk depozitoi kopje të këtyre *e-mail*-eve të cilat janë mbajtur në konsideratë për të arritur në konkluzionin e mësipërm, por gjatë seancës dëgjimore përfaqësuesit e UBT, konfirmuan se një pjesë e këtyre *e-maile*-ve janë ato që ankuesi ka depozituar pranë Komisionerit.

Në arsyetimin e Këshillit të Etikës nuk evidentohet se konkretisht cilat *e-mail*-e kanë përmbajtje shantazhuese, kërcënuese dhe mungesë zyrtare të komunikimit për të vlerësuar konkretisht përmbajtjen e tyre. Ajo që Këshilli i Etikës, evidenton, është dërgimi i e-*maile*-ve, me fabula me kafshë me qëllim krahasimin e kolegëve me personazhe kafshësh të librave, që sipas Këshillit të Etikës shkon përtej shkeljes etike. Nga *e-mail*-et e vendosura në dispozicion nga ankuesi, konstatohet se:

Me *e-mail* datë 17.12.2024, ankuesi në vijim të një njoftimi për pjesmarrje në një trajnim që do të zhvillohej për personelin e UBT-së në lidhje me konfliktin e interesit, ku theksohej se pjesmarrja në trajnim ishte e detyrueshme dhe mungesat në trajnim nuk justifikoheshin, shkruan: *" .....ndërkohë që pritej që të organizoheshin mbledhjet e analizave të punës mësimore dhe kërkimore në nivel fakulteti, nesër znj. B. na ka ftuar që të marrim pjesë (me detyrim) në një trajnim për konfliktin e interesit. Nisur nga fakti që sivjet universiteti ka rënie në numrin e studentëve të regjistruar, pritej që këto analiza të ishin më të thelluara. Si ka mundësi që është punuar kaq shumë dhe është marrë mbështetje e veçantë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe numri i studentëve në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit që është përfituesi më i madh i kësaj mbështetje numri i studentëve të regjistruar në vit të parë ra këtë vit rreth 30%? Ndofta dekanatet kanë nevojë për më shumë kohë. Ndofta duhej bërë një udhëtim në Vjenë në atmosferë Krishtlindjesh. Ndofta përgatitja e darkave festive ka kërkuar më shumë kohë. Ndofta do ta kemi analizën në janar. Le të presim edhe ca se nuk u bë qameti. Në këtë atmosferë festash dhe meqë nesër do të mësojmë për konfliktin e interesit unë po ju sjell një pjesë të shkurtër nga George Orwel. Pjesa është shkruajtur 80 vjet më parë.....". E-mail*-i vijon me citimin e një pjese të marrë nga vepra letrare Ferma e Kafshëve.

Në një tjetër *e-mail* të datës 13.1.2025, ankuesi shkruan:

" Zonja dhe zotërinj drejtues të niveleve të ndryshme të UBT,
Në mesazhin tim të datës 17 dhjetor 2024, unë shpreha mendimin tim që për shkak të nevojës së trainimit për konfliktin e interesit, të testimit të atmosferës vieneze të krishtlindjeve dhe të drekave/darkave festive, analizat e punës mësimore kërkimore mund të ishin shtyrë për në janar.
Tani, sipas një analize të thjeshtë të ngjarjeve del që nuk do të ketë më analiza për punën mësimore e kërkimore në nivel fakulteti. Kjo gjë konsiderohet kohë e humbur kot. Këtë e konfirmon edhe një mesazh që përfaqësuesi i departamentit tonë në Rektorat, shpërndau një javë më parë për ne. Nga ky komunikim mund të kuptohet që rektorati do ta çojë më tej eksperiencën e krijuar me Fermën didaktite ku është punuar sipas metodës "Rritja do të vijë nga zvogëlimi". Kjo metodë pritet të zbatohet edhe për kampusin qëndror të UBT. Ndërkohë që për fermën didaktike është e qartë se sa është zvogëlimi (të paktën hë për hë, pasi zvogëlimi për nevoja të rritjes mund të vazdojë në të ardhmen), për kampusin qëndror akoma nuk janë të qarta as zvogëlimi as rritja. Një gjë është e qartë, rektorati gjatë këtij viti do të jetë shumë i ngarkuar me punës. Kjo duket nga buxheti që ka miratuar. Për të përdorur në mënyrë efektive kohën, metoda e "Rritjes që vjen nga zvogëlimi" duket se do të mbështetet nga "Metoda e shprehjes së shpejtë të dakortësisë". Kjo e fundit i shmang mbledhjet e gjata dhe diskutimet e kota.

Duke ju uruar një fundjavë të mbarë, këtë herë, (nëse e gjeni të arsyeshme), unë ju ftoj që leximin e mëparshëm nga George Orwell ta plotësoni me këtë në vijim.....” E-mail-i vijon me citimin e një pjese të marrë nga vepra letrare Ferma e Kafshëve.

Në përmbajtjen e këtyre dy *e-mail*-eve të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit të ankesës, nuk konstatohet që ankuesi të ketë bërë krahasimin e kolegëve me personazhet kafshë të librit Ferma e Kafshëve, të autorit George Orwell. Kjo vepër duke qenë alegorike përdor personazhe apo ngarje që përfaqësojnë ide, koncepte ose realitete më të thella se ajo që duket. Historia që përcillet përveç kuptimit të drejtpërdrejtë ka edhe një kuptim tjetër, atë të mesazhit simbolik që kërkon të përcjellë. Duke qënë një vepër satirike, ajo përdor humorin, ironinë ose ekzagjerimin për të kritikuar shoqërinë, veset njerëzore ose padrejtësitë. Nëpërmjet pjesëve nga libri Ferma e Kafshëve, ankuesi duket se ka synuar të përcjellë qëndrimet e tij kritike në mënyrë alegorike dhe satirike, por nga përmbajtja e *e-mail*-eve të administruara nuk konsatohet që ai të ketë bërë krahasime apo etiketime të kolegëve me kafshë.

Vendimarrja e Këshillit të Etikës është në formën e propozimit. Pra, Këshilli i Etikës nuk është organi vendimarrës i cili jep masën disiplinore. Komisioneri vlerëson se, vendimarrja që cenon të drejtat e ankuesit është vendimi i Rektorit, i cili ka kompetencën që të japë masën dsiplinore. Mungesa e komunikimit të vendimit (propozues) të Këshillit të Etikës nuk ka sjellë cenim të të drejtave të ankuesit.

Me vendimin nr. 23, datë 9.4.2024, Rektori i UBT e ka zbutur masën disiplinore nga “largim nga detyra”, të propozuar nga Këshilli i Etikës me vendimin nr. 10, datë 7.3.2025, në masën disiplinore “paralajmërim për largim nga detyra”. Kjo masë është dhënë me motivacionin: *për sjellje të papërshtatshme në komunikimin institucional, si dhe në përdorimin e veprimeve agresive dhe gjuhës së papërshtatshme e jo etike në korrespondencën elektronike me kolegët dhe autoritetet drejtuese, në kundërshtim me normat e etikës dhe aktet e brendshme rregullative të universitetit.*

Sipas nenit 17, pika 3, të Kodit të Etikës së UBT-së masa disiplinore “vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra” jepet për shkelje të rënda, si dhe në rast se brenda një afati 6-mujor personeli ka marrë dy masa “vërejtje”. Referuar nenit 16, pika 1.b, janë shkelje të rënda rastet si më poshtë:

- Mospërmbushja e detyrave;
- Braktisja e punës ose mungesa e pajustifikuar dhe e vijueshme për 3 ditë pune apo më shumë, kur mungesa ka sjellë pasoja të rënda;
- Shkelje e përsëritur e rregullave të etikës në shërbimin civil;
- Sjellja e parregullt, në mënyrë të përsëritur, gjatë kohës së punës me eprorët, kolegët, vartësit, studentët dhe të tretët;
- Dëmtimi i pronës shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pronës shtetërore;
- Kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, e veprimeve që cenojnë ose demtojnë imazhin e Universitetit;

Sa më sipër konstatohet se, shkelja e konsideruar si shkelje e rëndë, për të cilën ndaj ankuesit është dhënë masa disiplinore "paralajmërim për largim nga detyra", e dhënë me vendimin nr.23, datë 9.4.2025, nuk rezulton që të ketë një përcaktim të qartë në raport me nenin 16, të Kodit të Etikës, ku përcaktohen llojet e shkeljeve disiplinore.

Në deklaratat e tyre personale pranë Këshillit të Etikës, z. E.I dhe z. H.P, të cilët kanë qene prezent kur ka ndodhur ngjarja e datës 8.11.2024, që është edhe objekti i ankesës së paraqitur nga Dekani i FBM, konfirmojnë se nga ana e ankuesit është përdorur shprehja e pretenduar "*I dua lekët se ti nxjerr nga rryli i fytit*". Ndërsa ankuesi pretendon se fjalët e tij janë shtrembëruar, pasi ai është shprehur "*Këto lekët e mia në rryl të fytit do t'ju ngelen*". Gjithashtu rezulton se, jo vetëm nga dëshmitë e personave që kanë qenë prezent por edhe nga deklarimet e ankuesit në seancë dëgjimore para Këshillit të Etikës se, biseda e datës 8.11.2024 midis tij dhe Dekanit të UBT nuk është zhvilluar me tone të qeta.

Rezulton se ka një shkelje të etikës në komunikim gjatë debatit të zhvilluar në datën 8.11.2024, midis ankuesit dhe Dekanit të UBT. Shkelja e rregullave të etikës, parashikohet si shkelje e lehtë, sipas nenit 16, pika 1.c të Kodit të Etikës. Në referim të nenit 17, pika 2, të këtij Kodi, për shkeljet e klasifikuara si të lehta jepet një masë disiplinore më e lehtë si "vërejtje me shkrim".

Komisioneri vlerëson se, në radhë të parë, në procedurën disiplinore të filluar mbi bazën e ankesës së Dekanit të FBM të datës 27.11.2024, objekti i procedurës është zgjeruar në fakte dhe rrethana që nuk kanë qenë pjesë e ankesës. Së dyti, nga aktet e administruara rezulton se, në mënyrë të pabazuar është arritur në përfundimin se, në komunikimet elektronike të ankuesit me kolegët dhe autoritetet drejtuese ka komunikim në kundërshtim me normat e etikës. Komunikimet elektronike të ankuesit që u administruan gjatë shqyrtimit të ankesës janë kritike dhe shpesh kritika bëhet edhe në formë alegorike dhe satirike, por kjo nuk do të thotë se ankuesi ka shkelur normat e komunikimit etik. Kritika nuk është lehtësisht e mirëpritur aq më tepër e shprehur në mënyrë alegorike dhe satirike.

Pavarësisht se me vendimin nr. 23, datë 9.4.2025, të Rektorit të UBT-së është zbutur masa disiplinore ndaj ankuesit nga "largim nga detyra" në "paralajmërim për largim nga detyra", baza për dhënien e masës disiplinore "paralajmërim për largim nga detyra", sipas vendimit nr.23, datë 9.4.2025 të Rektorit të UBT-së, mbetet fakti që në mënyrë të pabazuar ankuesi është konsideruar se ka shkelur në mënyrë të përsëritur normat e etikës në komunikim, si pasojë e komunikimeve të tij elektronike me kolegët dhe autoritetet drejtuese.

Përfundimisht Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të disfavorshme nga ana e UBT-së në lidhje me procedimin disiplinor për dhënien e masës disiplinore "Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra", sipas vendimit nr.23, datë 9.4.2025, të Rektorit të UBT-së.

B. Shkaku i mbrojtur.

Neni 1, i ligjit nr.10221, date 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", i ndryshuar (LMD), liston disa shkaqe, megjithatë kjo listë nuk është një listë e mbyllur, por ilustruese, fakt ky që rezulton nga përfshirja në këtë listë e shprehjes "*për çdo shkak tjetër*". Thënë kjo, nuk presupozon se, termi "*çdo shkak tjetër*" përbën një shkak në vetvete. Rregullimi i bërë nga neni 1, i LMD-së nëpërmjet termit "*çdo shkak tjetër*" mundëson mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqe të tjera, përveç shkaqeve të listuara shprehimisht në këtë dispozitë të ligjit, por duke identifikuar "*shkakun*" i cili pretendohet se gëzon mbrojtje në kuadër të termit "*çdo shkak tjetër*". Për të patur një pretendim për diskriminim, duhet domosdoshmërisht që të identifikohet një shkak, i cili në bazë të ligjit është i ndaluar ose i mbrojtur.

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, të LMD, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ky ligj ka bërë në nenin 3, të tij, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit, garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme, që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura.

Neni 1, i LMD është në linjë me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh. Krahas praktikës kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

LMD, por edhe legjislacioni ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi, nuk ka parashikime ose përkufizim se çfarë është shkaku i mbrojtur. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 14, i KEDNJ-së nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato diferenca të bazuara në një *karakteristikë personale të identifikueshme, objektive ose personale, ose "status", me të cilin personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëri-tjetri*.[4] Me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse/shkaqe të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14 i Konventës.

Në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë në radhë të parë se shkaku i pretenduar prej saj është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij.

Ankuesi ka identifikuar si shkaqe të pretenduara të diskriminimit "*xhelozinë e programeve tradicionale*" dhe "*qëndrimet e tij kritike, për mënyrën se si menaxhohet Universiteti Bujqësor i*

[4] Shih: *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 55; *Kjeldsen Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës,* prg 56; *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 61 dhe 70; *Novruk dhe të Tjerët kundër Rusisë, prg. 90.*

Tiranës dhe në mënyrë të veçantë për menyrën e trajtimit të programit të studimit arkitekturë peizazhi."

Ankuesi e lidh shkakun e pretenduar të diskriminimit "xhelozinë e programeve tradicionale" me pretendimin për diskriminim të programit të studimit Arkitekturë Peizazhi, pretendim të cilin bazuar në arsyetimin e mësipërm, Komisioneri vlerësoi se është një pretendim që nuk mund të pranohet për shqyrtim nga Komisioneri. Pavarësisht se ky shkak lidhet me një pretendim që nuk mund të ngrihet, Komisioneri vlerëson se bazuar në standartet e mësipërme, shkaku *"xhelozi e programeve tradicionale",* nuk përbën shkak të mbrojtur sipas LMD dhe nuk mund të gëzojë mbrojtje në kuadër të termit "*çdo shkak tjetër*", të parashikuar në nenin 1, të LMD.

Në kuadër të parashikimit "*çdo shkak tjetër*", të parashikuar nga neni 1, i LMD, ankuesi pretendon si shkak për diskriminimin "*qëndrimet e tij kritike, për mënyrën se si menaxhohet Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe në mënyrë të veçantë për menyrën e trajtimit të programit të studimit arkitekturë peizazhi*."

Bazuar në aktet e administruara, rezultoi e provuar se ankuesi gjatë ushtrimit të detyrës si pedagog pranë UBT ka shprehur kritika dhe problematika të herëpashershme për mënyrën se si promovohet dhe menaxhohet Universiteti Bujqësor i Tiranës, problematika të krijuara nga drejtuesit lidhur me programin e studimit arkitekturë peizazhi, mbi financimet në kuadër të ndërkombëtarizimit të universiteteve, kritika në lidhje me procedurat e ndjekuar për ngritjen e Komisionit të Studimeve dhe Kurikulës në kuadër të të projektit UBT-BOKU 2030, si dhe mënyrën e menaxhimit të këtij projekti[5].

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, bazuar në provat dhe aktet e administruara, rezultoi plotësisht e provuar se ankuesi e mbart shkakun e mbrojtur në kuadër të "*çdo shkaku tjetër*", sipas përcaktimit të nenit 1, të LMD-së, atë të shprehjes së "*qëndrime kritike, për mënyrën se si menaxhohet Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe në mënyrë të veçantë për menyrën e trajtimit të programit të studimit arkitekturë peizazhi*.".

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë me shkaqet e mbrojtura.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminmit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit *"Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional"*.

[5] Çështjet dhe problematikat e adresuara nga ankuesi janë parashtruar nëpërmjet disa *e-maileve* të administruara në dosje, ndër të tjera: *e-mail* datë 28.4.2023; *e-mail* datë 21.9.2023; *e-mail* datë 3, 10 dhe 19 qershor 2024; *e-mail* datë 20.1.2025; *e-mail* datë 13.01.2025; *e-mail* datë 17.12.2024; *e-mail* datë 27.1.2025; *e-mail* datë 10.2.2025.

Gjykata Kushtetuese[6], ka mbajtur qëndrimin se: *"E drejta për punë, që garanton neni 49/1 i Kushtetutës, përfshin zgjedhjen e profesionit, vendin e punës dhe sistemin e kualifikimit profesional me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Zgjedhja e profesionit, siç parashikohet nga dispozita kushtetuese, përbën një të drejtë të individit në kuptimin, që ai i përkushtohet një veprimtarie për të siguruar mjetet e jetesës. Kjo e drejtë e individit për të përfituar me punë të ligjshme fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi. E drejta për punë dhe liria e profesionit nënkuptojnë të drejtën e individit për të ushtruar çdo veprimtari të ligjshme që i sjell të ardhura dhe që nuk ka afat të përcaktuar, me përjashtim të rregullimeve të veçanta ligjore. Në këtë kuptim, veprimi i organeve shtetërore që sjell pasoja të drejtpërdrejta në pengimin e veprimtarisë profesionale përbën cenim të kësaj lirie veprimi. Garancia që Kushtetuta i jep individit lidhur me të drejtën për punë dhe lirinë e profesionit ka si qëllim mbrojtjen e këtyre nga kufizimet e papërligjura të shtetit. Liria e profesionit nuk është thjesht një e drejtë për të pasur një vend pune. Ajo nuk duhet kuptuar vetëm si e drejtë sociale, por dhe si liri negative që nuk lejon ndërhyrjen ose pengimin e shtetit gjatë ushtrimit të saj. Përcaktimi që neni 49 i Kushtetutës i bën të drejtës për punë duhet të merret në kuptim të dyfishtë. Ajo përbën një detyrim pozitiv që kërkon angazhimin shtetëror për të krijuar kushte të përshtatshme për realizimin e një të drejte të tillë, por edhe detyrim negativ, i cili kërkon mosndërhyrjen e shtetit për të cenuar këtë të drejtë".*

Neni 17, i Kushtetutës, përcakton: *"1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut."*

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Mbështetur në nenin 17, të Kushtetutës, *Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja),* zë një vend të veçantë në hierarkinë e normave juridike.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ-ja) si çështje që hyjnë në sferën e veprimit të nenit 8, *"E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare".* Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë të hapur shkaqesh. Ndërkohë Protokolli 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, shtrihet përtej të drejtave të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: *"a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë;*

[6] Vendimi nr. 20, datë 11.07.2006, i Gjykatës Kushtetuese.

b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm; c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës discrecionare; d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik".

E drejta për punë dhe mbrojtja nga diskriminimi në gëzimin e kësaj të drejtë parashikohet edhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria të tilla si, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore[7], Konventa Nr.111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës "*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit"*[8], Karta Sociale Europiane[9], e rishikuar.

Në rastin në fjalë kemi të bëjmë me një marrëdhënie pune midis një institucioni të arsimit të lartë publik dhe individit, e cila rregullohet nga Kodi i Punës. Parimi i mosdiskriminimit, përshkon në frymë dhe në nene këtë akt rregullator. Kodi i Punës, mbi bazën e të cilit janë rregulluar marrëdhëniet e punës midis ankueses dhe punëdhënësit, në nenin 9, sanksionon: *" 1. Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi. 3. Ndalimi i diskriminimit, i përcaktuar nga ky Kod, nuk zbatohet nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive. 4. Dallimet, kufizimet, përjashtimet ose parapëlqimet, që bazohen në një karakteristikë të lidhur me shkaqet e përmendura në pikën 2, të këtij neni, nuk përbëjnë diskriminim kur, për shkak të natyrës së aktiviteteve profesionale, ose të kushteve në të cilat profesioni ose veprimtaria ushtrohet, këto karakteristika përbëjnë një kërkesë të vërtetë dhe profesionale të domosdoshme, me kusht që qëllimi i trajtimit të ndryshëm të jetë i përligjur dhe kërkesa të mos kapërcejë atë çfarë është e domosdoshme për realizimin e saj. 5. Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me: ..... c) kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën;... "*

Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (V*endimet nr.* nr. 31 datë 04.10.2021, *nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përligjjes së arsyeshme dhe objektive. (vendimi nr. 19, datë 09.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese). Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe

[7] Ratifikuar me ligjin nr. 7511 datë 08.08.1991.
[8] Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.
[9] Ratifikuar me ligjin nr. 8960, date 24.10.2002

qëllimit që synohet të arrihet. *(Vendimet nr. 18, datë 29.07.2008 dhe nr.19, datë 09.07.2019 të Gjykatës Kushtetuese).*

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet[10]. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu cënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme[11]. Referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, *diskriminimi i drejtpërdrejtë*, edhe pse neni 14 i KEDNJ-së nuk jep një përkufizim të tij, konsiderohet si "*dallim në trajtim i personave në situata të njëjta ose të ngjashme" dhe "bazuar në një karakteristikë ose "status" të dallueshëm*""[12]

Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situata të jo të barabarta të mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë, konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme[13] .

LMD (neni 3, pika 1), e përkufizon diskriminimin si *çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.* Sipas LMD, një nga format e shfaqjes së diskriminimit është "*diskriminimi i drejtëpërdrejtë*". Sipas nenit 3, pika 2, të LMD, "*diskriminim i drejtpërdrejtë*" është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.

Në bazë të LMD, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në nenin 6, të tij, përcaktohet se: *"Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi"*.

LMD e konkretizon nenin 18 të Kushtetutës dhe është hartuar nën frymën e tij. Vendi ynë si vend anëtar i Këshillit të Europës dhe që ka ratifikuar Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, duhet që të veprojë në përputhje me Konventën dhe me vendimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, si organi që mbikëqyr zbatimin e saj.

---

[10] Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.
[11] Shih: Çështja *Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24.10. 2019.

[12] S*hih: Biao kundër Danimarkës, Dhoma e Madhe, datë 14.05.2016, § 89, Carson dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar,* Dhoma e Madhe 2010, datë 16.03.2010, prg. 61.
[13] Raporti Shpjegues që shoqëron Protokollin 12 të KEDNJ-së, prg 15.

Barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm. Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin nenin 33, pika 7/1 të LMD-së ku sanksionohet se : "*7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim*."

Një rregullim të posaçëm të barrës së provës për çështjet e diskriminimit në punësim dhe profesion e bën edhe Kodi i Punës, duke sanksionuar në nenin 9, pika 10, të tij se: *"10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë".*

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, pala ankuese duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

- Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
- Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin[14].

Parimi i zhvendosjes/shpërndarjes së barrës së provës, në çështjet e diskriminimit është i ngjashëm me atë të supozimeve të marra si të vërteta deri në vërtetimin e të kundërtës - *praesumptio iuris tantum* dhe po kështu bazohet tek logjika e përdorur për vendosjen e lidhjes mes fakteve që tregojnë trajtim të mundshëm diskriminues dhe ekzistencës së këtij trajtimi në realitet. Barra e provës zhvendoset/shpërndahet dhe pala kundër të cilës është paraqitur ankesa, për të vërtetuar se nuk ka patur diskriminim, duhet të rrëzojë supozimin faktik se ka patur diskriminim.

[14] https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime *"të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave…provat mund të vijnë nga bashkekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht me veçoritë e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe me të drejtat e pretenduara.".*[15] Pra, nëse faktet e prezantuara nga paditësi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ do t'i pranojë ato si të provuara, përveçse kur i padituri paraqet një shpjegim alternativ bindës.

GJEDNJ shprehet se: *"..... niveli i bindjes së nevojshme për arritjen e një përfundimi të caktuar dhe, në lidhje me këtë, shpërndaren e barrës së provës, janë të lidhura thelbësisht me specifikën e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe të drejtën në rrezik.".*[16]

Në lidhje me barrën e provës në çështjet e diskriminimit, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 16 datë 12.03.2024 (V-16/24), ka mbajtur qendrimin se: *"....aty ku ekzistojnë fakte nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim, i takon autorit të diskriminimit, në këtë rast punëdhënësit, të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të këtij parimi. Kalimi i barrës së provës nga punëmarrësi (viktima e diskriminimit) te punëdhënësi (autori i diskriminimit) lidhet me vulnerabilitetin e të diskriminuarit, ndaj ai mjafton të paraqesë fakte të besueshme që prezumojnë prima facie ekzistencën e një rrethane specifike diskriminuese që ka çuar në një trajtim më pak të favorshëm ose në shkaktimin e dëmit ndaj tij. Nga ana tjetër, gjykata ka detyrën për të verifikuar nëse faktet e pretenduara ekzistojnë dhe të vlerësojë nëse provat e paraqitura nga punëdhënësi janë të mjaftueshme për të nxjerrë konkluzionin se zgjidhja e marrëdhënieve të punës nuk ka qenë për shkaqe diskriminuese. Me fjalë të tjera, kjo do të thotë se barra e provës në lidhje me shkaqet për diskriminim në marrëdhëniet e punës i përket fillimisht punëmarrësit, por nëse ky i fundit paraqet disa fakte, të cilat mbështesin në mënyrë të arsyeshme një prezumim për diskriminim, barra e provës kalon te punëdhënësi."*

Komisioneri çmon të nevojshme të theksojë se, është bazuar pikërisht në standartin e mësipërm të të provuarit, gjatë shqyrtimit dhe konkluzioneve të arritura, në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Sa më sipër, Komisioneri arriti në përfundimin se, ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të disfavorshme nga ana e UBT-së në lidhje me procedimin disiplinor për dhënien e masës disiplinore "*Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra*", sipas vendimit nr.23, datë 9.4.2025, të Rektorit të UBT-së. Komisioneri arriti në përfundimin se, ankuesi i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm nga ana e UBT në lidhje me heqja e ditëve të punës për datat 11, 12, dhe 13 mars 2025, për shkak të pjesmarrjes në një aktivitet jashtë vendit. Nga ana tjetër, rezultoi plotësisht e provuar se ankuesi e mbart shkakun e mbrojtur në kuadër të "*çdo shkak tjetër*", sipas përcaktimit

[15] GJEDNJ *Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë* [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147.
GjEDNJ, *Timishev v. Rusisë* (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GjEDNJ, *D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.
[16] GJEDNJ *Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë* [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147.
GjEDNJ, *Timishev v. Rusisë* (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GjEDNJ, *D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

të nenit 1, të LMD-së, atë të shprehjes së "*qëndrime kritike, për mënyrën se si menaxhohet Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe në mënyrë të veçantë për menyrën e trajtimit të programit të studimit arkitekturë peizazhi*.". Në këto kushte, Komisioneri do të marrë në analizë lidhjen midis trajtimit të padrejtë dhe të disfavorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesi dhe shkakut të pretenduar të diskriminimit.

Në lidhje me pretendimet e tjera të parashtruara në ankesë, Komisioneri nuk arriti të konstatojë trajtim të padrejtë dhe të disfavorshëm të ankuesit. Rrjedhimisht këto pretendime nuk do të merren në analizë në pjesën vijuese të këtij vendimi.

Bazuar në përkufizimin që bën ligji për diskriminimin e drejtëpërdrejtë si një nga format e shfaqjes së sjelljeve diskriminuese, elementët kryesorë ose kyç që duhen vërtetuar janë si më poshtë:

(i) pala ankuese është trajtuar në mënyrë të të padrejtë dhe të pafavorshme në krahasim me mënyrën se si trajtohen, janë trajtuar apo do të trajtoheshin të tjerët, në një situatë të ngjashme;
(ii) shkaku i pretenduar i diskriminimit nga pala ankuese është një "shkak i mbrojtur" sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi;
(iii) dhe arsyeja për këtë është shkaku i pretenduar i diskriminimit.

- *Në lidhje me diskriminimin e pretenduar si pasojë e heqjes së tre ditëve punë për datat 11, 12, dhe 13 mars 2025, për shkak të pjesëmarrjes në një aktivitet të zhvilluar jashtë shtetit dhe lidhja me shkakun e pretenduar të diskriminimit.*

Konstatimi i trajtimit të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe ekzistenca e shkakut të pretenduar të diskriminimit, nuk mund të çojnë *a priori* në përfundimin se jemi përpara një sjellje diskriminuese, për sa kohë që nuk mund të prezumohet lidhja shkakësore, pra se arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është shkaku i pretenduar i diskriminimit.

Sa më sipër është arsyetuar, Komisioneri arriti në përfundimin se, ankuesi i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm nga ana e UBT në lidhje me heqja e ditëve të punës për datat 11, 12, dhe 13 mars 2025, për shkak të pjesmarrjes në një aktivitet jashtë vendit dhe gjithashtu rezultoi e provuar se ankuesi e mbart shkakun e mbrojtur në kuadër të "*çdo shkak tjetër*", sipas përcaktimit të nenit 1, të LMD-së, atë të shprehjes së "*qëndrime kritike, për mënyrën se si menaxhohet Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe në mënyrë të veçantë për menyrën e trajtimit të programit të studimit arkitekturë peizazhi*.".

Barra e provës për të provuar dhe vërtetuar se trajtimi i padrejtë dhe i disfavorshëm të cilit ankuesi i është nënshtruar si pasojë e heqjes së tre ditëve punë për datat 11, 12, dhe 13 mars 2025, për shkak të pjesëmarrjes në një aktivitet të zhvilluar jashtë shteti, nuk mund t'i kalojë subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, nëse nuk ndodhemi në kushtet e një diskriminimi *prima facia*, pra që mund të prezumohet se diskriminimi ka ndodhur.

Nga provat e administruara rezulton se, ankuesi ka marrë miratimin për lëvizje jashtë vendit në disa raste që përfshijnë përiudhën para dhe pas udhëtimit në datat 11-13 mars 2025, fakt ky që provohet nga praktikat e administruara me nr.2873 prot., datë 08.10.2024, nr.3070 prot., datë 25.10.2024, nr.1034 prot., datë 20.3.2025, nr.1223 prot, datë 8.4.2025, nr.2656 prot datë 3.9.2025 dhe nr.2657 prot., datë 14.10.2025. Gjatë periudhave të mësipërme kur ankuesi është pajisur me lejet përkatëse për të lëvizur jashtë vendit, shkaku i pretenduar i diskriminimit i cili ka qenë prezent, nuk rezulton që të ketë ndikur miratimin e lejeve.

Komisioneri vlerëson se, faktet dhe provat e administruara janë të pamjaftueshme për të ngritur një prezumim *prima facie* për diskriminim dhe për të prezumuar se trajtimi i padrejtë dhe i disfavorshëm në lidhje me heqjen e ditëve të punës për datat 11, 12, dhe 13 mars 2025, për shkak të pjesmarrjes në një aktivitet jashtë vendit ka ndodhur për shkak të "*qëndrime kritike të ankuesit, për mënyrën se si menaxhohet Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe në mënyrë të veçantë për menyrën e trajtimit të programit të studimit arkitekturë peizazhi*."

Sa më sipër Komisioneri arrin në përfundimin se pretendimi për diskriminim si pasojë e heqjes së tre ditëve punë për datat 11, 12, dhe 13 mars 2025, për shkak të pjesëmarrjes në një aktivitet të zhvilluar jashtë shtetit, nuk është i bazuar. Në këtë kuptim, Komisioneri konstaton se, ankuesit i janë hequr në mënyrë të pabazuar ditët e punës për datat që ai ka qene në aktivitet jashtë shtetit, por bazuar në faktet dhe provat e administruara, nuk mund të prezumohet se trajtimi i padrejtë të cilit i është nënshtruar ankuesi ka ardhur si pasojë e shkakut të mbrojtur.

- *Në lidhje me procedimin disiplinor për dhënien e masës disiplinore "Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra", sipas vendimit nr.23, datë 9.4.2025, të Rektorit të UBT-së dhe lidhja me shkakun e mbrojtur.*

Komisioneri vlerëson se, bazuar në faktet dhe provat e administruara, jemi në kushtet kur mund të prezumohet (*diskriminimi prima facie*) se në pamje të parë ankuesi është diskriminuar në lidhje me procedimin disiplinor për dhënien e masës disiplinore "*Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra*", sipas vendimit nr.23, datë 9.4.2025, të Rektorit të UBT-së për shkak të "*qëndrimeve të tij kritike, për mënyrën se si menaxhohet Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe në mënyrë të veçantë për menyrën e trajtimit të programit të studimit arkitekturë peizazhi*", bazuar në konstatimet e mëposhtme:

- Rezultoi e provuar se, ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të disfavorshme nga ana e UBT-së në lidhje me procedimin disiplinor për dhënien e masës disiplinore "*Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra*" , sipas vendimit nr.23, datë 9.4.2025, të Rektorit të UBT-së.

- Pavarësisht se me vendimin nr. 23, datë 9.4.2025, të Rektorit të UBT-së është zbutur masa disiplinore ndaj ankuesit nga "largim nga detyra" e propozuar nga Këshilli i Etikës, në "paralajmërim për largim nga detyra", baza për dhënien e masës disiplinore "*paralajmërim për largim nga detyra*", sipas vendimit nr.23, datë 9.4.2025 të Rektorit të UBT-së, mbetet fakti që

në mënyrë të pabazuar ankuesi është konsideruar se ka shkelur në mënyrë të përsëritur normat e etikës në komunikim, si pasojë e komunikimeve të tij elektronike me kolegët dhe autoritetet drejtuese.

- Komunikimet elektronike të ankuesit nëpërmjet të cilave ai ka shprehur qëndrimet e tij kritike, për mënyrën se si menaxhohet Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe në mënyrë të veçantë për menyrën e trajtimit të programit të studimit arkitekturë peizazhi, janë pikërisht komunikimet të cilat janë konsideruar në mënyrë të padrejtë si shkelje e etikës në komunikim. Këto komunikime janë vlerësuar si shkelje e përsëritur e rregullave të etikës, duke pasjellë që shkelja të konsiderohet si shkeje e rëndë dhe jo shkelje e lehtë.

- Klasifikimi i shkeljes si shkelje e rëndë e ka ekspozuar ankuesin ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm për shkak se, masa disiplinore që jepet në këtë rast është një masë më e rëndë, krahasuar me masën disiplinore që jepet në rast se shkelja do të ishte konsideruar si shkelje e lehtë. Janë "*qëndrimet kritike të ankuesit, për mënyrën se si menaxhohet Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe në mënyrë të veçantë për menyrën e trajtimit të programit të studimit arkitekturë peizazhi*", shkak ky i mbrojtur në kuadër të "*çdo shkak tjetër*" sipas përaktimeve të nenit 1, të LMD, faktori determinant që ka çuar në aplikimin ndaj ankuesit të një mase disiplinore më të rëndë sikurse është "Paralajmërim për largim nga detyra".

- Zgjatja dhe shtimi i objektit të hetimit administrativ pranë Këshillit të Etikës, është jo vetëm i pabazuar, por kishte si qëllim vetëm përfshirjen e komunikimeve elektronike nëpërmjet të cilave ankuesi ka bërë publike qëndrimet e tij kritike.

- Në referim të nenit 68, të ligjit nr. 80/2025, Këshilli i Etikës nuk ka të drejtë që të propozojë largimin nga detyra të personelit akademik, sepse një gjë e tillë është kompetencë e drejtuesit të njësisë bazë.

Në kushtet kur, jemi përpara një *prezumimi se diskriminimi ka ndodhur*, UBT, *ka barrën e provës që të provojë të kundërtën*, pra që veprimet e tij, nuk përbëjnë diskriminim. Këtë, punëdhënësi/UBT mund ta realizonte duke treguar se, nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të ankuesit, ose duke provuar se megjithëse trajtimi i pafavorshëm është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, në mënyrë që hidhte poshtë pretendimin për diskriminim.

Sa më sipër rezultoi e provuar se, komunikimet elektronike të ankuesit nëpërmjet të cilave ai ka shprehur qëndrimet e tij kritike, për mënyrën se si menaxhohet Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe në mënyrë të veçantë për mënyrën e trajtimit të programit të studimit arkitekturë peizazhi, janë pikërisht komunikimet të cilat janë konsideruar në mënyrë të padrejtë si shkelje e etikës në komunikim. Këto komunikime janë vlerësuar si shkelje e përsëritur e rregullave të etikës, duke pasjellë që shkelja të konsiderohet si shkeje e rëndë dhe jo shkelje e lehtë dhe ndaj ankuesit të aplikohet një masë disiplinore më e rëndë siç është "Vërejtje me paralajmërim nga detyra"

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.329, datë 12.04.2017 "*Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik*", pika 3, paragrafi i dytë që përcakton se: "*Personeli akademik nuk mund të penalizohet për shkak të qëndrimeve të tij ndaj politikave të institucionit. Në të gjitha rastet, personeli akademik vepron brenda normave të etikës, në respekt të institucionit dhe kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi*".

Gjatë procedurës administrative të zhvilluar nga Komisioneri për shqyrtimin e ankesës, punëdhënësi/UBT nuk paraqiti ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për të provuar se komunikimet elektronike të ankuesit nëpërmjet të cilave ai ka shprehur qëndrimet e tij kritike ndaj politikave dhe mënyrës së menaxhimit të institucionit, përbëjnë shkelje të normave të etikës.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se ankuesi Z.T është diskriminuar, gjatë procesit disiplinor për marrjen e masës disiplinore "Paralajmërim për largim nga detyra" sipas vendimit nr.23, datë 9.4.2025, të Rektorit të UBT-së për shkak të "*qëndrimeve kritike, për mënyrën se si menaxhohet Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe në mënyrë të veçantë për menyrën e trajtimit të programit të studimit arkitekturë peizazhi*.". Për rrjedhojë, UBT, ka shkelur dispozitat e ligjit nr.10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, nenin 1, nenin 3, pikat 1 dhe 2, nenin 5 dhe nenin 12, pika 1. germa "c".

Në mungesë të trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë të ankuesit në lidhje me pretendimet e tjera të parashtruara në ankesë Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr.10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të LMD, përcaktohet se: "*Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre".* Në nenin 33, pika 12, të LMD-së, përcaktohet se: *"Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës"*

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese të shkaktuar ndaj ankuesit, duhet të jetë marrja e masave për të rishikuar vendimin nr. 10, datë 9.4.2025 të Rektorit të UBT-së, për dhënien e masës disiplinore ndaj ankuesit "*Paralajmërim për largim nga detyra*" me qëllimin që qëndrimet kritike të ankuesit, për mënyrën se si menaxhohet Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe në mënyrë të veçantë për mënyrën e trajtimit të programit të studimit arkitekturë peizazhi, të shprehura nëpërmjet komunikimeve elektronike të mos e cenojnë ankuesin, në lidhje me klasifikimin e shkeljes disiplinore.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi",* i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të ankuesit Z.T nga ana e Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT), gjatë procedimit disiplinor për dhënien e masës disiplinore *"Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra",* të marrë me vendimin nr.23, datë 9.4.2025, të Rektorit të UBT-së, për shkak të "*qëndrimeve të tij kritike, për mënyrën se si menaxhohet Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe në mënyrë të veçantë për menyrën e trajtimit të programit të studimit arkitekturë peizazhi*.", në kuadër të "*çdo shkak tjetër*", sipas përcaktimeve në nenin 1, ligjit nr. 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi",* të ndryshuar.
2. Në referencë të pikës 1 të Vendimit, Universiteti Bujqësor i Tiranës duhet të marrë masa për të rishikuar vendimin nr.23, datë 09.04.2025, të Rektorit të UBT-së "*Për dhënien e masës disiplinore "Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra" ndaj Prof.Dr.Zydi T. , staf akademik në kategorinë "Profesor" në Departamentin e Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peisazhit, pranë Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit*".
3. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit Z.T , në lidhje me pretendimet dhe shkaqet e tjera të diskriminimit të parashtruara në ankesë.
4. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, Universiteti Bujqësor i Tiranës, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkaku:	çdo shkak tjetër
Fusha:	Punësim
Lloji i Vendimit:	Diskriminim +Mosdiskriminim